



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Informatikë Ekonomike”**

**ofruar nga**

**Kolegji Universitar “Bedër”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Ezmolda BAROLLI**

**Dr. Elva LEKA**

**Tetor / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në "Informatikë Ekonomike"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Informatikë Ekonomike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 248, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2021 – 2022 – 7 PAE/ 2PAK 77%/23% v.a. 2022 – 2023 – 10PAE/ 7PAK 58%/41% v.a. 2023 – 2024 – 13PAE/ 8PAK 61%/39%
18	Numri i studentëve:	v.a. 2021 – 2022 – 16 studentë v.a. 2022 – 2023 – 28 studentë v.a. 2023 – 2024 – 25 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, Kolegji Universitar “Bedër”.

Hapja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 248, Nr. 4037 Prot., datë 19.07.2021, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e Informatikës Ekonomike.

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike” në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, të Kolegjit Universitar “Bedër”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2021 – 2022. Në vitin akademik 2021 – 2022, janë regjistruar 16 studentë, në vitin akademik 2022 – 2023, 28 studentë, në vitin akademik 2023 – 2024, 25 studentë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli dhe Dr. Elva Leka, me mbështetjen e koordinatorit të ASCAL, MSc. Rajna Lila.

Procesi i vlerësimit të jashtëm në bazë të agjendës ka filluar më 07.03.2024, me dorëzimin nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës. Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një agjende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Kolegjin Universitar “Bedër”, në datat 7 dhe 8 Mars 2024, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, Përgjegjës të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.



*Kolegji Universitar "Bedër", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.09.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 101 / 9 Prot, datë 24.09.2024. Kolegji Universitar "Bedër", njofton në ASCAL më datë 30.09.2024, me anë të shkresës me Nr.27/4 Prot, datë 30.09.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 27/4 Prot, Datë 30.09.2024.*

### **Përgjigje mbi "Komente mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm"**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**"Informatikë Ekonomike"**

**Kolegji Universitar "Bedër"**

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.3, Kriteri 4**: Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

**GVJ:** Mungon evidentimi në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuara laboratoreve dhe detyrave të kursit/projekteve.

**GVB:** Gjatë vizitës në institucion është kërkuar nga ekspertët vënia në dispozicion e evidencës shtesë të kurrikulës së konfiguruar sipas një shpërndarjeje kreditesh të kategorizuar në leksione seminare, laboratore etj. Një material i tillë është vënë në dispozicion si evidencë shtesë menjëherë nga grupi i punës dhe po i ribashkëngjitet kësaj kthim përgjigje për referencë. Shpërndarja specifike e organizuar në orët dhe kreditet përkatëse dhe e kategorizuar sipas zërave leksione, seminare, laboratore dhe detyra kursi është e paraqitur e detajuar dhe në aneks, Tabela 10. Ky dokument, i përditësuar i bashkëngjitet këtij relacioni. (Evidencë mbështetëse nr. 1: Plani Mësimor për Programin e Studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike").

**GVJ:** GVJ merr në konsideratë sqarimin e bërë nga Institucioni në lidhje me shpërndarjen e krediteve siç është organizuar në kurrikulën e vendosur në dispozicion. Sidoqoftë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar [Evidenca shtesë 1 Plani mësimor i detajuar Tabela 10.pdf, Evidenca nr. 40: Syllabuset e Lëndëve], RVJ has në dy çështjet e mëposhtme:

- a. Mungon evidentimi i krediteve referuar Detyrës së Kursit;
- b. Shpërndarja e temave javore në Syllabuset e lëndëve, nuk është organizuar në leksione, seminare, laboratore etj. respektivisht sipas krediteve përkatëse të lëndës. Ndaj GVJ sugjeron që temat javore në syllabus-et e lëndëve, të pasqyrohen sipas kategorizimit përkatës leksion, seminar, laborator, detyra kursi praktikë për secilën javë, duke përcaktuar ngarkesën mësimore përkatëse javore.

Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht si më poshtë:

**Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, GVJ vëren se:**

- Në syllabus-et e lëndëve paraqiten vetëm temat javore, pa kryer klasifikimin i tyre specifikisht, me orët përkatëse në cdo javë sipas ndarjes në leksioneve, seminareve, laboratoreve dhe detyrave të kursit.
- në Planin mësimor të detajuar dhe syllabuset e lëndëve, mungon përcaktimi i krediteve të lidhura me detyrën e kursit.

**GVJ rekomandon:**

- Të pasqyrohet në syllabuse shpërndarja e temave javore për leksionet, seminarët, laboratorët dhe detyrat e kursit.
- Të evidentohen në kurrikul dhe syllabuse kreditet dhe orët përkatëse të dedikuara për Detyrën e Kursit.

2. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.3, Kriteri 4: Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.**

**GVJ:** GVJ konstaton që departamenti nuk ka paraqitur një procedurë në lidhje me ankimimin e notës.

**GVB:** Lidhur me këtë koment, Kolegji Universitar Bedër disponon një procedurë institucionale për ankimimin e notës së bashku me formularin përkatës shoqëruar të ankimimit i cili plotësohet nga studentët në rastet kur ka kundërshtim note. Dy dokumentët e sipërpërmendur i bashkangjiten për referencë këtij relacioni. (Evidencë mbështetëse nr. 2: Procedura e Ankimit të Rezultateve të Provimeve; (Evidencë mbështetëse nr. 3: Formular Aplikimi për Kundërshtim Note).

**GVJ:** GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion vlerëson faktin që Kolegji Universitar Bedër ka një procedurë instucionale për ankimimin e notës.

**Raporti në këtë pikë ndryshon (Hiqet rekomandimi i dhënë)**

3. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.3, Kriteri 6: Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.**

**GVJ:** GVJ vëren se programi Bachelor në “Informatikë Ekonomike” nuk ka një procedurë për anonimitetin e kryerjes së provimeve.

**GVB:** Një pjesë e mirë e provimeve në Programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” zhvillohen duke përdorur Google Forms, Test Portal, në kompjuter dhe përgjigja e tyre del automatikisht. Vetë përdorimi i këtyre platformave siguron anonimitetin. Nga ana tjetër, për lëndë të tjera, provimi organizohet duke shënuar vetëm ID-në e studentit

në tezën e provimit. Një shembull vlerësimi provimi me element kodimi numrin e ID-së i bashkëngjitet këtij relacoini. (Evidencë mbështetëse nr. 4: Kodimi i provimit).

**GVJ:** GVJ vlerëson faktin që institucioni për testimin e provimit përdor platforma Google Forms apo Test portal, duke automatizuar kështu procesin e duke ruajtur anonimitetin e studentit.

**Raporti në këtë pikë ndryshon (Hiqet rekomandimi i dhënë)**

4. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.3, Kriteri 2:** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.

**GVJ:** GVJ vëren se nuk gjen një dokument specifik ku të evidentohen marrja e masave apo analizimi i rezultateve të marra nga pyetsorët. Sugjerojmë që njësitë bazë të përfshijnë analizat e rezultateve të pyetsorëve në raportet e tyre vjetore.

**GVB:** Ashtu sikundër konstatohet edhe nga GVJ citoj: - “Sikurse është evidentuar edhe në Kriterin 4 (Standardi VI.2), GVJ u informua që institucioni vlerëson rezultatet e pyetsorëve të cilët shërbejnë për të matur performancën e programit të studimit në tërësi, dhe rezultatet ju bëhen të ditura organeve drejtuese, Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Sipas RVB dhe takimit që GVJ zhvilloi me drejtuesit, ata pohuan se në institucion hartohen raporte të vlerësimit, të cilat evidentojnë praktikën më të mira dhe adresojnë problemet.” (RVJ, Standardi IV.3 Kriteri 2). Pra ashtu sikundër konfirmohet edhe nga vetë ekspertët rezultatet e anketave dhe pyetsorëve bëhen pjesë e diskutimeve proaktive në departament me qëllim marrjen e masave në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Evidenca mbështetëse bashkëngjitur kësaj kthim përgjigje (Evidencë mbështetëse nr. 5: Diskutimet e anketave të studentëve në mbledhjen e Këshillit të Departamentit) reflekton minutat e takimit të një mbledhjeje të njësisë ku rezultatet e anketave janë bërë pjesë e diskutimeve në mes të anëtarëve.

**GVJ:** GVJ vlerëson përgjegjen e institucionit në lidhje me këtë pikë, dhe rikonfirmon konstatimet e veta të cilat janë të paraqitura në vlerësimin e **Standardit IV.3, Kriteri 2.** Sugjerimi i GVJ në këtë vlerësim është që: *“njësitë bazë të përfshijnë analizat e rezultateve të pyetësorëve në raportet e tyre vjetore”*. Kjo gjë nuk është evidentuar dhe mbështetur me dokumenta, as në dokumentat e konsultuara në sistemin AMS gjatë hartimit të RVJ, dhe as në Evidencën Shtesë dërguar me komentet nga institucioni. Evidenca mbështetëse nr. 5: *“Diskutimet e anketave të studentëve në mbledhjet e Këshillit të Departamentit”* nuk paraqet këtë gjë.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Ezmolda BAROLLI**

**Dr. Elva LEKA**

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>	
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij [Evidencë 1, Neni 4, fq. 6], Kolegji Universitar “Bedër” ka mision të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. Kolegji Universitar “Bedër” realizon misionin e tij përmes zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente [Evidencë 1, Neni 4 pika 3, fq. 6].  Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi të cilat janë në përputhje me kriteret e Përcaktuara nga “Karta e Bolonjës” dhe legjislatcini shqipëtar për arsimin [Evidencë 15]. <i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i> <i>Evidenca nr. 15. Plani Strategjik Institucional 2018-2023 Signed.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e Kolegjit Universitar “Bedër” për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj të cilët do të kontribuojnë në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë me aftësitë e tyre





<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>analitike, shkencore, teknologjike, sociale, financiare dhe kritike në sektorët publik ose privat [Evidencë 1] [Evidencë 5, fq. 5] dhe në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit për vendet e Europës Juglindore (SEE 2020), Teknologjisë dhe Inovacionit (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë me Biznesin (BITS), me Strategjinë për TIK (miratuar me Vendim KM Nr. 2016, datë 10.04. 2003 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim [Evidencë 5], përmes të cilës, në kuadër të interesit rajonal, Kolegji Universitar “Bedër”, synon, ndër të tjera, përgatitjen e individëve të mirëkualifikuar, produktivë, të orientuar drejt kërkimit shkencor dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5. Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike Copy.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i Studimeve Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të brendshëm të institucionit [Evidencë 15] dhe në përputhje me strategjinë e departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit [Evidencë 16 fq. 2], duke qënë një vazhdim i suksesshëm i programit Bachelor në Financë Kontabilitet.</p> <p>Ky program studimi është zhvilluar në bazë të nevojave të tregut të punës [Evidencë 5], mbështetur në “Rregulloren Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”” [Evidencë 3] dhe në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.</p> <p>Programi i studimit ka për qëllim të përgatisë profesionistë në fushën e ekonomisë, biznesit dhe teknologjisë së informacionit dhe synon të kontribuojë në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar.</p> <p><i>Evidenca nr. 15. Plani Strategjik Institucional 2018-2023 Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5. Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike Copy.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e njësisë kryesore të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit (FTB). Në përbërje të tij FTB ka gjithashtu Departamentin e</p>






<p>fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Shkencave Kompjuterike dhe Qendrën e zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Inovacion, duke demonstruar kapacitet e nevojshme për ofrimin e programit.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij [Evidencë RVB, Tabela 2, faqe 67].</p> <p>Gjatë vitit akademik 2023 – 2024, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit ka në përbërje të tij 9 personel akademik efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 0 Prof. Dr;</li> <li>- 1 Prof. Asoc;</li> <li>- 2 Dr;</li> <li>- 2 Dr. Proc</li> <li>- 4 MSc;</li> </ul> <p>3 personel akademik me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 0 Prof. Asoc. Dr;</li> <li>- 1 Dr;</li> <li>- 2 MSc;</li> </ul> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit disponon, në funksion të programeve të studimit që ofron, laboratorë bashkëkohore përmes të cilëve, studentët realizojnë orët praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre [Evidencë RVB, Tabela 1, faqe 67] [Evidencë 81].</p> <p><i><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></i></p> <p><i><a href="#">Evidenca nr. 81. Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër Signed.pdf</a></i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit , si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Ofrimi i këtij programi studimi fushën e Teknologjisë dhe Ekonomisë/Biznesit duke qenë në përputhje akademike dhe kërkimore me qëllimet e Fakultetit. Me qëllimin e përputhshmërisë është propozuar dhe kryer riorganizimi i njësisë kryesore pranë Kolegjit Universitar “Bedër”, sipas vendimit të MAS, Nr. 200, nr. Prot. 2254/2, në datën 03.07.2020 [Evidencë 43].</p> <p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces. Këshilli i Departamentit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ka propozuar kodifikimin e</p>




	<p>Programit të studimit sipas fushës së gjerë dhe specifike të klasifikuar në këtë vendim si dhe në klasifikimin unesco.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Riorganizimi i njësive kryesore në Kolegjin Universitar Bedër Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 43. Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë Signed.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni disponon infrastrukturën laboratorike dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Informatikë Ekonomike" realizohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, mbështetur në rregulloren e Kolegjit Universitar "Bedër" [Evidencë 3] si dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik nga fakultete të tjera të Kolegjit Universitar "Bedër", si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Evidencë 44] [Evidencë 46] [Evidencë 47] [Evidencë 48] [Evidencë 49] [Evidencë 50]</p> <p>Marrëdhënia midis strukturave të ndryshme brenda Kolegjit Universitar "Bedër" njësive të ndryshme administrative dhe akademike rregullohet përmes rregullores së brendshme të</p>

Institucionit [Evidencë 3] [Evidencë 10, Neni 1] [Evidencë 11, Neni 1 dhe Neni 2].

Nga RVB dhe nga vizita në institucion, **RVJ konstaton se** Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, në fillim të vitit akademik përcakton [Evidencë 42] [Evidencë 51] [Evidencë 61] [Evidencë 70]:

- Ndarjen e detyrave dhe koordinimin e personelit akademik të departamentit, duke bërë të mundur koordinimin dhe bashkëpunimin e të gjitha njësive dhe zyrave administrative si edhe mbikqyrjen e aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare
- Këshitarët akademik për çdo grup studentësh;
- Përfaqësuesin e departamentit në zyrën e planifikimit të karrierës
- Asistentin e departamentit për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Analizat e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe administrativ e realizuar nga Institucioni, tregojnë rezultate shumë të kënaqshme referuar rezultateve të mbledhura nga analiza e formularëve të vlerësimit të lëndëve, analiza e strukturës së cilësisë së provimit si edhe procesin e vlerësimit të kurrikulës apo përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit të programeve [Evidencë 46].

Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf

Evidenca nr. 44. Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik Signed.pdf

Evidenca nr. 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Signed.pdf

Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf

Evidenca nr. 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies Signed.pdf

Evidenca nr. 49. Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Signed.pdf

Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve për institucionin Signed.pdf

Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf

Evidenca nr. 10. Rregullorja mbi Organizimin Akademik Signed.pdf

	<p><u>Evidenca nr. 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 38. Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulave Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 42. Miratimi i Udhëzuesit të Këshilltarit Akademik Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 51. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 70. Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2023-2024 Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit Kolegji Universitar “Bedër” ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase si: University of Applied Sciences ‘Lavoslav Ruzickca’ në Kroaci, West University of Timisoara në Rumani, Pontifical University of Salamanca, University of Rome Tor Vergata në Itali, University of Rzeszow, Powislanski Yniversity, University of Economics and Humans Sciecnes në Varshavë etj. [Evidencë: Vetedeklarim bachelor informatike ekonomike.pdf, Tabela 5], të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara [Evidencë 75] [Evidencë 76] [Evidencë 25].</p> <p><i>Nga vizita në institucion, takimi me stafin akademik, dhe takimin me studentët GVJ konstaton se programi i studimit kishte kryer një sërë shkëmbimesh pedagogësh dhe studentësh me këto institucione.</i></p> <p>Në kuadër të marrëveshjeve Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit kanë organizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Konferencën Ndërkombëtare ICIBT</b> në partneritet me universitete shqiptare, rajonale dhe europiane si: Universiteti EPOKA, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Universiteti Fan S. Noli, Kolegji AAB, University of Economics and Human Sciencesin Waraw. (<a href="https://icibt.beder.edu.al/">https://icibt.beder.edu.al/</a>)</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Shkollën verore “Teknologjia Financiare dhe shoqërisë së Informacionit”</i> në bashkëpunim me Universitetin e Tor Vergatës në Romë.</li> <li>- <i>Konferencën studentore “Transformimi Digjital në kohën e sfidave”</i>, në bashkëpunim me Universitetin Fan S. Noli në Korçë.</li> </ul> <p>Gjithashtu, Kolegji Universitar “Bedër” në bashkëpunim me 30 universitete të tjera, si anëtar i shoqatës EUMMAS, ishte pjesë e konferencës “EUMMAS A2S Conference on Global Social and Technological Development and Sustainability”.</p> <p><u><i>Vetedeklarim bachelor informatike ekonomike.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 75. Lista e marreveshjeve institucionale dhe Erasmus + Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 25. Marrëveshje mobiliteti Erasmus + Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të informatikës ekonomike, si: Coomunication Progress, Deloitte Albania, Online Marketing Albania, Eurosig, Praktika.al, Business Technology Solutions, Academy of European Languages, Dhoma Ekonomike e Gruas, Protik Albania, Atom Computers [Evidencë RVB, Tabela 5, faqe 71] etj.</p> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit, dhe Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qëllim ekspozimin ndaj praktikave të studentëve [Evidencë 45].</p> <p><u><i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 45. Shembull aplikimi praktike Copy.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale për të gjithë studentët e tij, në përputhje me programin e studimit të ofruar [Evidencë 45] [Evidencë 111].</p> <p>Për të analizuar arritjet dhe për të përcaktuar objektivat, kryhen raporte vjetore të realizuara nga Departamenti [Evidencë 67] dhe Raporte Vjetore Institucionale [Evidencë 13].</p>

funksion të realizimit të programit të studimit.	<p><u>Evidenca nr. 45. Shembull aplikimi praktike Copy.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 111. Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutim dhe analize mbi pjesmarrjen e studentëve në internshipe Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 67. Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023 Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 13. Raporti vjetor institucional, për vitin akademik 2022-2023 Signed.pdf</u></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</i></p> <p><i>Kolegji Universitar "Bedër" falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i></p> <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që Institucioni ka kryer shkëmbime të stafit akademik dhe të studentëve me institucionet partnere.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që	Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit pranë Kolegjit Universitar "Bedër", është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 29] [Evidencë RVB, tabela 9].</p> <p>Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Mbështetur në VKM-në e mësipërme, janë ndërtuar në përputhje të plotë edhe kurrikula dhe planprogramet e lëndëve.</p> <p><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është zhvilluar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve (KSHK), të dispozitave të ligjit numër 10247, datë 04.03.2010. Orientimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” i specifikuar edhe në Statutin e Universitetit [Evidencë 1], demonstroi aftësi kërkimore të cilat janë të disponueshme në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit.</p> <p>Objektivat kryesore formuese të këtij programi, mbështetur në Nivelin 6 në KSHK, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që një student i diplomuar në Bachelor në Informatikë Ekonomike duhet të plotësojë janë [Evidencë 5]:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor me njohuri të avancuara në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë, duke përfshirë analizën kritike të teorive, parimeve, vlerësimeve të njohurive, mjeteve dhe pajisjeve si edhe kriterëve të performancës;</li> <li>Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për aftësi të avancuara në sistemet informatike duke demonstruar inovacion, zgjidhje të problemeve komplekse, përmirësimin e sigurimit të cilësisë;</li> <li>Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke i përgatitur për përgjegjësi vendimmarrje.</li> </ol> <p>Kurrikula e programit hap rrugë për shumë profesione si: analistë ekonomike ose statistikë, menaxherë, dizajnues të sistemeve inteligjente ekonomike, konsulentë të sistemeve IT, analistë të të dhënave etj.</p>

	<p><u>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 5. Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike Copy.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 35, Neni 15] [Evidencë RVB, Tabela 9, faqe 75]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (A) – 30 ECTS – 16.67 %,</li> <li>- Lëndë karakterizuese (B) – 95 ECTS – 52.78%,</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 25 ECTS – 13.89 %</li> <li>- Lëndë plotësuese (D) – 24 ECTS – 13.33 %,</li> <li>- Detyrime përmbyllëse (E) – 6 ECTS – 3.33 %.</li> </ul> <p>GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpërndarja e veprimtarive formuese është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</li> </ul> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përputhet plotësisht me kërkesat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të ministrave nr. 41, date 24.01.2018 [Evidencë 29].</p> <p>Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) janë parashikuar 5 lëndë në lidhje me “Hyrje në Financë”, “Hyrje në Algoritme dhe Programim”, “Programim i Orientuar në Objekte”, “Siguri të dhënash” dhe “Praktika Profesionale” gjithsej 24 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 6 ECTS, e cila mund të realizohet me Provim Përfundimtar ose me punim Mikroteze, nëse studenti plotëson kriterin e mesatares më të lartë se 3.0, sikurse janë parashikuar në rregulloren e studimeve të provimeve të cikit të parë dhe atë të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” [Evidencë 6] [Evidencë 35, Neni 15 dhe 16].</p> <p>GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41:</p> <p>Programi i studimit i ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse.</p>

	<p><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve vendas dhe të huaj bazuar në Statutin e Universitetit [Evidencë 1, Neni 69], Rregulloren Themelore [Evidencë 3], Rregulloren e Programit të Studimit [Evidencë 35], bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</p> <p><u>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtesë.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ka në kurrikul bazuar në ekperiencat e universiteteve që ofrojnë këtë program studimi dhe ka një përmbajtje të ngjashme me to.</p> <p>Institucioni është në proces të kodifikimit të programeve të studimit që ofrohen në të tre ciklet e studimit në përputhje me fushën specifike të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces. Kolegji Universitar “Bedër” është në proces të kodifikimit të të gjitha programeve që ofron aktualisht [Evidencë 73].</p> <p><u>Evidenca nr. 73. Propozime për kodifikimin e programeve të studimit në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit Signed.pdf</u></p>

<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë.		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e informatikës ekonomike. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>Kolegji Universitar “Bedër” ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.2</b>										
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>										
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>									
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore është e përbërë nga këto njësi bazë [Evidencë 7] [Evidencë 8]:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Ekonomisë;</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;</li> <li>3. Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion.</li> </ol> <p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit në vitin akademik <b>2023-2024</b> është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (9 pedagogë PAE) dhe 3 Personel Akademik me Kontratë, dhe 1 Personel Ndhmës akademik, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë: [Evidencë RVB, Tabela 1]</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit		PAE	PAK	Prof.Dr	1	-
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit									
	PAE	PAK								
Prof.Dr	1	-								

Prof.Asoc	3	-
Dr/PhD	4	3
Dr. Proc	6	-
Msc	10	12
<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>15</b>
	<b>39 totali</b>	

Njësia bazë, **Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit** përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë [Evidencë RVB, Tabela 2, faqe 61]:

Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	-	1	-	1	-
Dr./PhD.	2	-	2	1	2	1
Msc.	4	-	5	1	6	2
<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>

Nga sa më sipër Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.

*Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV, takimi me GVB dhe Zyrën e Burimeve njerëzore në Institucion, GVJ rekomandon që të shtohet stafi akademik grada shkencore e tituj akademikë.*

Evidenca nr. 7. Riorganizimi i njësive kryesore në Kolegjin Universitar Bedër Signed.pdf

Evidenca nr. 8. Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf

Vetedeklarim bachelor informatike ekonomike.pdf

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit angazhon në kuadër të praktikave profesionale dhe laboratoreve staf akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimet përkatëse për realizimin korrekt të tyre [Evidencë RVB, Tabela 1,2], duke përdorur udhëzimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p><i><a href="#">Vetedeklarim bachelor informatike ekonomike.pdf</a></i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinator për programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Informatikë Ekonomike” është Dr. E.D [Evidencë 51]. Koordinator i programit zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 35].</p> <p>Secilit grup studentësh, u caktohet një konsulent, i cili është pedagog pranë Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, dhe e udhëheq studentin në rrugëtimin akademik e shkencor [Evidencë 12, Neni 6, fq. 4].</p> <p><i><a href="#">Evidenca nr. 51. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit Signed.pdf</a></i></p> <p><i><a href="#">Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</a></i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për realizimin e ngarkesës në pëputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, për realizimin e mësimdhënies me cilësi dhe për krijimin e hapësirave për angazhimin e stafit në kërkim shkencor rekomandon rekrutimin e stafit të ri për të krijuar mundësinë e rishpërndarjes së ngarkesës.</i></p> <p><b>GVJ konstaton se:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b><i>Ka mungesë të stafit akademik me tituj akademikë</i></b></li> </ul> <p><b>GVJ rekomandon:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b><i>Të rekrutohet staf me tituj akademikë</i></b></li> </ul>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.3**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin [Evidencë 1] dhe rregulloren e Kolegjit Universitar “Bedër” [Evidencë 3], rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të parë [Evidencë 6].</p> <p>Informacione të nevojshme për organizimin, strukturën dhe kurrikulën e programit paraqitet në [Evidencë 11, Neni 38, Neni 39]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Versionin fizik nga njësia bazë dhe kryesore dhe depotizohet pranë administratorit të fakultetit dhe koordinatorit të departamentit;</li> <li>- Versionin digjital në sistemin BIS (<a href="https://ecobus.beder.edu.al/">https://ecobus.beder.edu.al/</a>)</li> </ul> <p><i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në planin mësimor [Evidencë 29] të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, si dhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 40] jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 35, Neni 5,8,11,13], si dhe risillen brenda syllabusit të çdo lënde [Evidencë 40]:</p> <p>Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm.</p> <p>Secili syllabus përmban informacion në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emri, kodi dhe kategoria e lëndës</li> <li>• Pozicioni i lëndës në afatin trevjeçar (vit+semestër)</li> <li>• ECTS të lëndës dhe vlerat e krediteve</li> </ul>

- *Kategoria e lëndës (A, B, C, D apo E)*
- *Përcaktimin nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje*

Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes [Evidencë 40]:

- *Testimet e ndërmjetme*
- *Laboraret*
- *Detyrat e kursit*
- *Provimi përfundimtar.*

Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë [Evidencë 35, Neni 20]:

<b>Nota (Sipas sitemit shqiptar)</b>	<b>Shpjegimi</b>	<b>Sistemi i vlerësimit (Nota)</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Pikët</b>
10	<b>Ekselent</b>	4.00	A	90-100
9	<b>Shumë mirë</b>	3.66	A-	85-89
9	<b>Shumë mirë</b>	3.33	B+	80-84
8	<b>Mirë</b>	3.00	B+	75-79
8	<b>Mirë</b>	2.66	B-	70-74
7	<b>Mjaftueshëm</b>	2.33	C+	65-69
7	<b>Mjaftueshëm</b>	2.00	C	60-64
6	<b>Mjaftueshëm</b>	1.66	C-	55-59
6	<b>Mjaftueshëm</b>	1.33	D+	50-54

	<b>5</b>	<b>Kalues</b>	1.00	D	45-49
	<b>4</b>	<b>Jokalues</b>	0.66	D-	40-44
	<b>4</b>	<b>Jokalues</b>	0	F	0-39
	<p><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>				
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Kolegji Universitar “Bedër” ofron burime të ndryshme për t’i pajisur studentët me informacionet e nevojshme referuar kriterëve të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione jepen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregulloren e programit të studimit [Evidencë 35, Neni 11, 5, 39, 9];</li> <li>- Rregulloren e Transferimit e studimeve [Evidencë 41];</li> <li>- Si edhe në udhëzuesin “Guidën e studentit” [Evidencë 28], i cili u ofron informacione të përditësuara për çdo vit akademik në lidhje me pranimin, regjistrimin apo transferimin.</li> </ul> <p>Pranimi në programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe RASH, para fillimit të aplikimeve për pranime [Evidencë 22] [Evidencë 10, Neni 8, pika 3].</p> <p>Kriteret publikohen në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar “Bedër” të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë të intersuarit.</p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>				

	<p><u>Evidenca nr. 41. Rregullorja për transferimin e studimeve Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 22. Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 10. Rregullorja mbi Organizimin Akademik Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Evidencë 40], hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 [Evidencë 40], bazuar në planin mësimor të programit [Evidencë 29], të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p><i>Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, GVJ vëren se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në syllabus-et e lëndëve paraqiten vetëm temat javore, pa kryer klasifikimin i tyre specifikisht, me orët përkatëse në cdo javë sipas ndarjes në leksioneve, seminarëve, laboratoreve dhe detyrave të kursit.</li> <li>- në Planin mësimor të detajuar dhe syllabuset e lëndëve, mungon përcaktimi i krediteve të lidhura me detyrën e kursit.</li> </ul> <p>GVJ rekomandon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të pasqyrohet në syllabuse shpërndarja e temave javore për leksionet, seminarët, laboratorët dhe detyrat e kursit.</li> <li>• Të evidencohen në kurrikul dhe syllabuse kreditet dhe orët përkatëse të dedikuara për Detyrën e Kursit.</li> </ul> <p><u>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 91. Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24.01.2018 Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale</p>	<p>Programi i studimit për Informatikë Ekonomike nuk ka pësuar ndryshime bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi programi duhet që të kalojë akreditimin e parë dhe më pas mund të propozojë ndryshime. Ndërkohë, në përputhje me Politikën e Kolegjit Universitar “Bedër” për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit [Evidencë 46] dhe Politikat e Sigurimit të Cilësisë së Kolegjit Universitar “Bedër” [Evidencë 52], bëhet një rishikim vjetor i programit të studimit Bachelor në</p>




dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Informatikë Ekonomike, i cili përfshin vlerësimin e efektivitetit dhe identifikimin e fushave për përmirësim duke përfshirë modifikimet e kurrikulës [Evidencë 29].</p> <p><i>Evidenca nr. 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 52. Politika e cilësisë Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit.</i></p> <p><i>Instucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut, ndryshimet më të fundit teknologjike dhe literaturën bashkëkohore.</i></p> <p><i>Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, GVJ rekomandon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Në syllabus-et e të realizohet shpërndarja e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë referuar secilës kategori: leksion, seminar, laborator dhe detyre kursi.</i></li> <li>- <i>Të evidentohen në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1-2 orë në auditor).</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të</b>	Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 29, Evidencë 40]. Viti akademik është i organizuar në semestra.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim, «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Përgjatë tre viteve të studimit, me anë të lëndëve të cilat zhvillohen, studentët përgatiten që të zbatojnë parimet informatike në fushën e informatikës ekonomike, kërkimit shkencor, por edhe për t'u pajisuar me aftësi për të punuar në grup dhe për të pasur role drejtuesi.</p> <p>Në planin mësimor të programit përfshihen lëndë që ofrojnë njohuri teorike dhe praktike në fushën e informatikës dhe ekonomisë si: Bazat e programimit në Web, Menaxhimi i Bazës së të Dhënave, Statistikë, Financë, Kontabilitet Mikro dhe Makro Ekonomi, Marketing e lëndë të profilit juridik.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [<u>Evidencë 35, Neni 15</u>] [<u>Evidencë RVB, Tabela 9, faqe 75</u>]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (A) – 30 ECTS – 16.67 %,</li> <li>- Lëndë karakterizuese (B) – 95 ECTS – 52.78%,</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 25 ECTS – 13.89 %</li> <li>- Lëndë plotësuese (D) – 24 ECTS – 13.33 %,</li> <li>- Detyrime përmbyllëse (E) – 6 ECTS – 3.33 %.</li> </ul> <p>Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 6 ECTS. Shpërndarja e lëndëve në semestra duke filluar nga lëndët formuese në vitin e parë, deri te ato bërthamë në vitin e dytë, e më tej në lëndët me zgjedhje bëhet sipas një rrjedhe logjike të programit përputhur me rezultatet e të nxënit të secilës lëndë, në përputhje me rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Informatikë Ekonomike”.</p> <p>GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpërndarja e veprimtarive formuese është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</li> </ul> <p><u><i>Evidenca nr. 35. Rregulloria e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në</p>	<p>Struktura e programit “Informatikë Ekonomike” ka një fokus të madh në aftësitë praktike, duke ofruar një raport të mirë të teorisë dhe praktikës me qëllim ofrimin e një shpërndarjeje të</p>






<p>përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>balancuar ndërmjet lëndëve të profilit të profilit ekonomik dhe atyre të profilit informatik [Evidencë 29], i hartuar në përputhje të plotë me parimet e kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve.</p> <p>Program është hartuar në përputhje edhe me programe të tjera studimi të suksesshme të informatikës ekonomike duke u konsultuar me kurrikula të programeve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bachelor në Informatikë Ekonomike – Univesiteti i Tiranës;</li> <li>- Bachelor Business Informatics – Universiteti Europian i Tiranës;</li> <li>- Bachelor in Economics Informatics – Universiteti Metropolitan i Tiranës;</li> <li>- Bachelor Informatike Ekonomike – UAMD</li> <li>- Bachelor në Informatikë Ekonomike – University of New York Tirana.</li> <li>- Business Informatics – South East European University in North Macedonia</li> <li>- Bachelor in Business Informatics – Universiteti i Vjenës.</li> </ul> <p><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” duke ofruar një kurrikul të pasur moderne me fokus në pjesët teorike dhe praktike, nxit një shkallë të lartë të punësimit, sidomos në studentët e viteve të treta. Studentët e degës “Informatikë Ekonomike” duke u pajisur me aftësi të fushës ekonomike dhe informatike, bëhen të aftë në ndjekjen e studimeve të niveleve më të larta jo vetëm në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por edhe në universitete ndërkombëtare. Përafrimi i programit me modelet kombëtare dhe ndërkombëtare mundëson transferimin e studentëve [Evidencë 41] [Evidencë 103], dhe mobilitetet e studentëve përmes programeve Erasmus + [Evidencë 104].</p> <p>Mobilitetet studentore në kuadër të Erasmus+ janë kryer me University of Rome Tor Vergata në datat 15/02/2024 deri 05/07/2024 në Departamentin e Ekonomisë për studentët Rea Hoxha, Luxhejna Tafa, Xhoi Shahini.</p> <p><i>GVJ nga vizita nga dokumentat e vendosura në dispozicion dhe nga vizita në Institucion konstaton se institucioni nxit pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete.</i></p>

	<p><i>Evidenca nr. 41. Rregullorja për transferimin e studimeve Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 103. Vendim i Komisionit AD-HOC për njohjen e krediteve për transferim Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 104. Shkëmbi i studentëve Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve [Evidencë 40] në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit duke kryer mbledhje të Këshillit të Departamentit me fokus rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve [Evidencë 112]. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuar nga ana e përmbajtjes, metodologjisë, dhe literaturës ndihmëse të 5 viteve të fundit, të cilat vihen në dispozicion të studentëve dhe ngarkohen në sistemin e universitetit “Beder Information System (BIS)” [Evidencë 109]. Programi i lëndës firmoset dhe dorëzohet pranë koordinatorit të departamentit [Evidencë 40].</p> <p><i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 112. Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 109. Shembull sylabusi të përditësuar Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave [Evidencë 5], për t’u punësuar në fushën e ekonomisë dhe informatikës, vendas dhe të huaj, në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë <i>Master Profesional</i> dhe <i>Master i Shkencave</i> në përputhje me profilin e studimit.</p> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit në Kolegjin Universitar “Bedër”, është në marrëdhënie të vazhdueshme me industrinë, për të përputhur programin e studimit me nevojën e tregut të punës [Evidencë 76].</p> <p>Programi i studimit ofron lëndë si Shkrim Akademik apo Metoda kërkimore, të cilat ndihmojnë studentët të përfitojnë njohuri të thelluara për të kryer kërkim shkencor e për të ndjekur ciklin tjetër të studimeve [Evidencë 29]. Njohja e studentëve me lëndë me orientim profesional si; Programim në Java, Programim në Web, Programim Mobile, Data mininig,</p>

	<p>Sisteme Operative, Kontabilitet, kontabilitet financiar si dhe praktika profesionale e deyrueshme lehtëson procesin e integritit të studentëve në tregun e punës [Evidencë 76] [Evidencë 29, Tabela nr. 5].</p> <p><i><u>Evidenca nr. 5. Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike Copy.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave.</i></p> <p><i>GVJ nga vizita nga dokumentat e vendosura në dispozicion dhe nga vizita në Institucion konstaton se institucioni nxit pjesëmarrjen e studneteve në mobilitete ndërkombëtare në kuadër të Erasmus +.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin</b>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është në procesin e tij të parë të akreditimit dhe rezultatet e sondazhet nuk janë ende të disponueshme. Në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të programit i përcaktuar në "Politikat e Përmirësimit të Programit" [Evidencë 46] realizohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i programit të studimit nga studentët e regjistruar realizohet në semestrin e fundit në prag diplomimi [Evidencë 47];</li> </ul>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i cilësisë së programit nga studentët e diplomuar që realizohet pasdiplomimit [Evidencë 4];</li> <li>- Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga ekspertë të jashtëm ose bashkëpunëtorë të fushës realizohet pas diplomimit të brezit të parë e në vazhdim;</li> <li>- Zyra e Planifikimit të Karrierës në bashkëpunim me Këshilltarin e Karrierës dhe departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit organizon takime të studentëve me bashkëpunëtorët dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i i punës [Evidencë 61].</li> </ul> <p>Misioni i këtij formimi është të sigurojë që programet e studimit përmbushin kërkesat e sektorit privat e të përditësojë kurrikulat në mënyrë të tillë që t'u ofrojë studentëve aftësitë e nevojshme për të qenë të aftë në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar.</p> <p><i><u>Evidenca nr. 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 4. Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës Signed.pdf</u></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 6], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 47].</p> <p>Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit të studimit kryhen në disa drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përfaqësues të studentëve marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Departamentit ku mund të përcjellin mendimet dhe vlerësimet e grupit mbi programin dhe lëndët specifike [Evidencë 71];</li> <li>2. Plotësimi i anketës së vlerësimit që realizohet për çdo lëndë [Evidencë 34];</li> <li>3. Përfshirja në senatin akademik, organin më të lartë vendimmarrës, të kryetarit të këshillit studentor,</li> </ol>

	<p>përcaktuar në Statutin e Institucionit [Evidencë 34, Neni 10];</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. Përfshirja në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evidencë 34, Neni 28];</li> <li>5. Përfshirja e studentëve në Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë [Evidencë 16] [Evidencë 97].</li> <li>6. Përfshirja e studentëve në Këshillin e Departamentit [Evidencë 71].</li> </ol> <p><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 71. Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.pdf Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 97. Vendimi i zgjedhjes së Komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilesisë Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 71. Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi përgjegjëse e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, kujdeset për përmirësimin, përditësimin e programit të përshtatur me propozimet dhe zhvillimet e fundit dhe duke marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve në fushën e ekonomisë dhe atë informatike. Prej viztave të bashkëpunimit kërkimor dhe bashkëveprimit me ortakët dhe palët e interesuara, merren në konsideratë propozimet e tyre për përmirësimin dhe përshtatjen e programit [Evidencë 112].</p> <p>Departamenti organizon mbledhjen e Këshillit të departamentit për diskutimin në lidhje me syllabuset, me qëllim përmirësimin e programit [Evidencë 112].</p> <p><u>Evidenca nr. 112. Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve Signed.pdf</u></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ nga vizita në Institucion dhe nga dokumentat e vendosura në dispozicion konstaton se institucioni merr në konsideratë mendimin e studentëve dhe të bashkëpunëtorëve të tij për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Mekanizmat qe përdor në këtë drejtim janë: (1) mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar; (2) përfshirja e studentëve në organet më të larta vendimmarrëse si: Këshilli i Departamentit; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë; (3) takimet dhe marrja e “feedback-ut” nga partnerë e bashkëpunëtorë në tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X






### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Metodologjitë e mësimdhënies së përdorura në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përshkruhen në Rregulloren Themelore [Evidencë 3, Neni 78, pika 3], Rregulloren e Ciklit të parë të studimeve [Evidencë 6, Neni 11], Rregulloren e Programit të Studimit [Evidencë 35, Neni 13], ku përfshihen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione në auditor;</li> <li>- Seminare të cilat mund të organizohen në auditor apo laborator;</li> <li>- Laboratore;</li> <li>- Seanca praktike profesionale të zhvilluara në auditor</li> <li>- Prezantime në baza javore për lëndët për lëndët e bazës së projektit;</li> <li>- Detyra javore;</li> <li>- Leksionet të hapura, të organizuara në formën e workshop-eve dhe seminareve apo trajnimeve nga profesionistë të fushës [Evidencë 70],;</li> <li>- Praktika Profesionale, e parashikuar si lëndë e detyrueshme në semestrin e gjashtë [Evidencë 35, Neni 16], .</li> </ul> <p>Ngarkesa në auditor e studentëve [RVB, Tabela 13] është e organizuar në leksione (1500 orë), seminare (480 orë), ushtrime/labororë (135 orë), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (0 orë), praktikë profesionale (45 orë) dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (45 orë), gjithsej 2205 orë.</p> <p><i><u>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 70. Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2023-2024 Signed.pdf</u></i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><i><u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u></i></p> <p>Mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Evidencë 29], e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional.</p> <p>Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve [Evidencë 101] [Evidencë 102]. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit përgjegjës për programin e studimit, parashikon gjatë gjithë vitit akademik konsulta të vazhduara të pedagogëve me studentët për plotësimin e nevojave të tyre.</p> <p>Me qëllim analizimin dhe përditësimin e nevojave të studentëve, në fund të çdo semestri akademik, studentët kryejnë procesin e vlerësimit e anketimit të syllabuseve [Evidencë 34].</p> <p>Gjithashtu si mënyrë për të përcjellë zërin, propozimet apo ankesat e studentëve një pjesë e tyre marrin pjesë në mënyrë periodike në Këshillin e Departamentit [Evidencë 71].</p> <p><i><u><a href="#">Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</a></u></i></p> <p><i><u><a href="#">Evidenca nr. 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër Signed.pdf</a></u></i></p> <p><i><u><a href="#">Evidenca nr. 101. Lista e trajnimeve me qellim përmirësimin e aftësive didaktike Signed.pdf</a></u></i></p> <p><i><u><a href="#">Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</a></u></i></p> <p><i><u><a href="#">Evidenca nr. 71. Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit Signed.pdf</a></u></i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër”, dhe në mënyrë të veçantë Departamentin i Ekonomisë dhe Biznesit, mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit. Në formularin periodik të vetëvlerësimit të stafit akademik parashkohen objektivat për vitin pasardhës akademik dhe planet për trajnimet e personelit [Evidencë 39]. Institucioni ndjek politika të tilla, që ofron trajnime të ndryshme apo leksione të hapura për të mbështetur stafin</p>




akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mësimdhënies [Evidencë 69] [Evidencë 100] [Evidencë 101].

Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) [Evidencë 75] i kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike.

Stafi akademik inkurajohet duke u mbështetur për pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo publikime në revista, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur interesin e tyre në kërkimin shkencor [Evidencë 19].

Për përmirësimin e zhvillimit të procesit mësimor, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, ofron infrastrukturë të konsoliduar IT për Shërbimet Mësimore duke përmendur [Evidencë RVB, Tabela nr. 16]: (1) Sistemin BIS [Evidencë 24] [Evidencë 110]; (2) Rrjetin; (3) Shërbimet Google; (4) Mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimet e programit etj.

*Megjithatë, nga vizita në institucion dhe nga takimi me stafin akademik PAE/PAK, GVJ konstatoi se:*

- "Stafi akademik mbështetet duke mos paguar "fee-në" e publikimit në revistë apo pjesëmarrjes në Konferencë në ato revista apo konferenca në të cilat Kolegji Universtar "Bedër" është partner apo bashkëpunëtor."
- Institucioni nuk ofron një procedurë për mbështetje financiare vjetore në lidhje me kërkimin shkencor në revista me faktor impakti të indeksura apo revista ndërkombëtare të cilat do të rrisin cilësinë e kërkimit shkencor.

*Evidenca nr. 39. Formular vlerësimi për stafin akademik Signed.pdf*

*Evidenca nr. 69. Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2020-2022 Signed.pdf*

*Evidenca nr. 100. Program seminaresh 2022-2023 Signed.pdf*

*Evidenca nr. 101. Lista e trajnimeve me qëllim përmirësimin e aftësive didaktike Signed.pdf*

*Evidenca nr. 75. Lista e marreveshjeve institucionale dhe Erasmus + Signed.pdf*

*Evidenca nr. 19. Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore Signed.pdf*

	<p><u>Evidenca nr. 110. Screenshot i Sistemit BIS Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS) Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</b>  Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës në Kolegjin Universitar “Bedër” [Evidencë 23].</p> <p>Tërheqja dhe rekrutimit të stafit të kualifikuar akademik, si një ndër objektivat strategjike të Kolegjit Universitar “Bedër” realizohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në përputhje me synimet dhe standardet e përcaktuara në Planin Strategjik të Institucionit [Evidencë 15, Kapitulli III, pika A];</li> <li>- Përmes “Rregullores së Punësimit” [Evidencë 44, Neni 5, pika 6];</li> <li>- Nëpërmjet një procesi vlerësimi dhe verifikimi nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit.</li> </ul> <p>Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik [Evidencë 54].</p> <p>Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve, bazuar edhe në udhëzuesin që Kolegji Universitar “Bedër” ka hartuar në lidhje me vijeshmërinë e mësimin, realizimin e programeve të kurseve përkatëse “Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU “Bedër”” [Evidencë 102].</p> <p>Referuar komunikimit pedagog-student:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lektorët këshillojnë, orientojnë dhe mbështesin studentët gjatë gjithë procesit të mësimdhënies si dhe përgatitjes për diplomimin përmes konsultimeve individuale/grup;</li> <li>- Këshilltari akademik ndjek nga afër procesin e mësimnxënies së studentëve [Evidencë 42];</li> <li>- Guida e stafit jep udhëzimet/direktivat për të siguruar një marrëdhënie sa më të shëndoshë dhe etike ndërmjet lektorit dhe studentit [Evidencë 27].</li> </ul>

	<p><u>Evidenca nr. 23. Procedura e rekrutimit të stafit akademik Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 15. Plani Strategjik Institucional 2018-2023 Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 44. Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 54. CV -të e stafit akademik Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 42. Miratimi i Udhëzuesit të Këshilltarit Akademik Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 27. Guida e Stafit Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta [Evidencë 4], në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 34], të cilat zhvillohen në mënyrë të përsëritur, 2 herë në çdo semestër përpara testimit përfundimtar.</p> <p>Pyetësori mban pyetje në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përpikëmerinë e pedagogëve;</li> <li>- Përgatitjen e lëndës;</li> <li>- Zotërimin e njohurive të lëndës;</li> <li>- Literaturën dhe materialet shtesë të lëndës;</li> <li>- Ndërveprimin mes studentëve;</li> <li>- Metodatat e mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së studentëve dhe menaxhimi i kohës.</li> </ul> <p>Organet kolegjiale të Kolegjit Universitar “Bedër” parashikojnë përfshirjen e studentëve në mbledhjet e njësive kryesore, njësive bazë si dhe në mbledhjet e këshillit të departamentit ku diskutohen çështje me interes të përbashkët mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor [Evidencë 71].</p> <p>Varësisht rezultateve të pyetësorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjësi zhvillon takime individuale me pedagogët vlerësimi i të cilëve është nën mesatare apo që kanë komente shqetësuese nga studentët;</li> </ul>

	<p>- Organizohen trajnime dhe seminare të ndryshme në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies.</p> <p><u>Evidenca nr. 4. Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar “Bedër” funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, njësi e cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional [Evidencë 17].</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit [Evidencë 71, Neni 6]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 kryetar;</li> <li>- 2 përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore (një për cdo fakultet);</li> <li>- 1 përfaqësues i Këshillit Studentor;</li> <li>- 1 ekspert i jashtëm</li> </ul> <p>Për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, operon gjithashtu organi kolegjal “Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit” specifike [Evidencë 16].</p> <p>Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike [Evidencë 102].</p> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve [Evidencë 39] [Evidencë 47] dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik [Evidencë 69] [Evidencë 101].</p> <p>NJSBC së bashku me Zyrën e Kërkimeve dhe Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore, Fakultetet përkatëse si dhe anëtarët e tjerë kryejnë trajnime të rregullta për zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës bazuar në nevojat e</p>



Strategjisë Institucionale dhe Planin e Veprimit. Këtu mund të përmendim:

- Trajnime të kryera nga NJSBC (<http://qac.beder.edu.al>);
- Trajnime të kryera nga NJSBC në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Qendrueshëm dhe Inovacion (<https://csdi.beder.edu.al>);
- Trajnime të kryera nga Zyra e Projekteve në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore;
- Trajnime të stafit akademik të realizuar nga "Educators without Borders" [Evidencë 88].

Për të matur performancën dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe performancën kërkimore shkencore, njësia bazë koordinon plotësimin nga çdo anëtar i stafit akademik të "Formularëve të Vetëvlerësimit", i cili bazohet në pikat kryesore si [Evidencë 49]:

- Kërkimi shkencor;
- Mësimdhënia;
- Kontributi në jetën universitare;
- Shërbimi publik që ka kryer;
- Aktivitetet akademike;
- Aktivitetet profesionale.

*Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf*

*Evidenca nr. 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.pdf Signed.pdf*

*Evidenca nr. 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër Signed.pdf*

*Evidenca nr. 39. Formular vlerësimi për stafin akademik Signed.pdf*

*Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf*

*Evidenca nr. 69. Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2020-2022 Signed.pdf*

*Evidenca nr. 101. Lista e trajnimeve me qëllim përmirësimit të aftësive didaktike Signed.pdf*

*Evidenca nr. 88. Marrëveshje me Education Without Borders Signed.pdf*

	<i>Evidenca nr. 49. Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Signed.pdf</i>		
<b>Konkluzione</b>	<p>Kolegji Universitar "Bedër" kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</p> <p>GVJ nga vizita në Institucion dhe nga takimi me grupin e studentëve konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët ishin të përfshirë në pjesëmarrje konferencash studentore të organizuar nga Kolegji Universitar "Bedër"</li> <li>- Programi i studimit përgatit profesionistë konkurrues në tregun e punës. Një pjesë e studentëve ishin të punësuar tashmë nga kompani partnere apo kompani të tjera, në profesionin e tyre.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit janë: provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar me seminare workshope, frekuentime e studime laboratorike bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregulloren themelore të Kolegjit Universitar "Bedër" [Evidencë 3, Kreu 12, Kreu 13];</li> <li>- Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë [Evidencë 6, Neni 16, Neni 22];</li> <li>- Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" [Evidencë 35, Neni 20, Neni 27];</li> <li>- Udhëzuesin për mësimdhënien Inovative [Evidencë 102];</li> </ul> <p>Pas përfundimit të procesit të regjistrimit studentët pajisen nga Zyra e Regjistrimit me "Guidën e studentit" [Evidencë 28], me anë të së cilës informohen mbi politikën, proceset dhe mekanizmat që drejtojnë studimet e tyre. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe i</p>

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimit [Evidencë 29].			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në rregulloren mësimore dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes [Evidencë 40]:			
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Testimet e ndërmjetme</i></li> <li>• <i>Laboraret</i></li> <li>• <i>Detyrat e kursit</i></li> <li>• <i>Provimi përfundimtar.</i></li> </ul>			
	Në total student/i/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë [Evidencë 35, Neni 20]:			
<b>Nota (Sipas sitemit shqiptar)</b>	<b>Shpjegimi</b>	<b>Sistemi i vlerësimit (Nota)</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Pikët</b>
10	Ekselent	4.00	A	90-100
9	Shumë mirë	3.66	A-	85-89
9	Shumë mirë	3.33	B+	80-84
8	Mirë	3.00	B+	75-79
8	Mirë	2.66	B-	70-74
7	Mjaftueshëm	2.33	C+	65-69
7	Mjaftueshëm	2.00	C	60-64
6	Mjaftueshëm	1.66	C-	55-59
6	Mjaftueshëm	1.33	D+	50-54
5	Kalues	1.00	D	45-49

	<b>4</b>	<b>Jokalues</b>	0.66	D-	40-44
	<b>4</b>	<b>Jokalues</b>	0	F	0-39
<p>Planprogramet e secilës lëndë publikohen gjithashtu në faqen e Internetit të Kolegjit Universtar “Bedër” (<a href="https://www.beder.edu.al">https://www.beder.edu.al</a>).</p> <p>Gjithashtu studentëve u vjen në ndihmë platforma “Bedër University System” (BIS) [Evidencë 24], [Evidencë 110] përmes së cilës studentët përditësohen mbi pikët e marra në vlerësim, mungesat dhe përmbytjet e lëndëve të zhvilluara.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS) Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 110. Screenshot i Sistemit BIS Signed.pdf</i></u></p>					
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorsit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 35], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 32] [Evidencë 34], të cilët hartohen në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evidencë 17].</p> <p><u><i>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p>				

	<p><i>Evidenca nr. 32. Rregullore e anketave dhe vlerësimeve Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit vendos në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme teknologjike për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim realizimin e objektivave formues të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës [Evidencë 102, Evidencë 29]. Përfshirja e studentëve, nën mbikqyrjen e pedagogëve të lëndëve, në rindërtimin e situatave reale në laborator përmes pajisjeve laboratorike në dispozicion, i aftëson në profesion dhe inkurajon sensin e tyre të autonomisë.</p> <p>Me qëllim promovimin shkencor, përveç trajnimeve të ndryshme të stafit akademik, <i>njësia përgjegjëse angazhohet për të garantuar njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor, duke bashkëpunuar me institucione të tjera në organizimin konferencave për të nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet duke u bazuar në më shumë se</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>një komponent, në përputhje me Vendimi VKM 41 më datë 24.01.2018 [Evidencë 91]. Format e vlerësimit parashikohen në: (1) Rregulloren Themelore [Evidencë 3, Neni 100]; (2) Rregulloren e Ciklit të parë të Studimeve [Evidencë 6, Neni 23]; (3) Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” [Evidencë 35, Neni 26].</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është kombinim i vlerësimeve të ndryshme, të specifikuar nga pedagogu i lëndës [Evidencë 29; Evidencë 40]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• provimi i ndërmjetëm</li> <li>• detyrat e kursit</li> <li>• laboratore</li> <li>• quize/projekte</li> <li>• provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë. Për të siguruar transparencën e procesit në lidhje me periudhën e zhvillimit të provimeve të ndërmjetme apo përfundimtare, institucioni bën publik në faqen e tij zyrtare kalendarin akademik.</p> <p><u><a href="#">Evidenca nr. 91. Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24.01.2018 Signed.pdf</a></u></p> <p><u><a href="#">Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</a></u></p> <p><u><a href="#">Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</a></u></p> <p><u><a href="#">Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</a></u></p> <p><u><a href="#">Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</a></u></p> <p><u><a href="#">Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” vë në zbatim sistemin interaktiv “Sistemi Informativ Bedër (BIS)” për t’u ofruar studentëve mundësi në lidhje me menaxhimin e procedurave për lëndën, si notat, frekuentimin, transkriptin apo përzgjedhjen e lëndëve duke ofruar transparencë për studentët, pedagogët, koordinatorin dhe drejtuesin e departamentit [Evidencë 24].</p> <p>Provimet kryhen në formatin e mëposhtëm:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <u>Testeve në kopje fizike</u>, ku studentët vendosin një kod të personalizuar (Id-ne e tyre) të cilin e di vetëm studenti dhe koordinatori i departamentit, me qëllim që të ruhet anonimiteti dhe të shmangen forma të ndryshme abuzimi;</li> <li>- <u>Testimi elektronik</u> duke përdorur platformën “<u>Testportal</u>” me qëllim rritjen e trasparencës. Secilit student i shfaqen pyetje të ndryshme dhe rezultati u shfaqet në mënyrë automatike duke shmangur forma të ndryshme abuzimi [Evidencë 93];</li> <li>- Testimi elektronik, duke përdorur <u>Google Forms</u>, dhe vlerësimi bëhet në mënyrë automatike, e secili prej studentëve merr notën në mënyrë individuale tezën dhe vlerësimin.</li> </ul> <p><u>Evidenca nr. 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS) Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 93. Shembull Provimi me Testim elektronik Web Programming Midterm Exam Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Vlerësimi përfundimtar është kombinim i vlerësimeve të ndryshme, të specifikuar nga pedagogu i lëndës [Evidencë 29; Evidencë 40].</p> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë.</p> <p><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Procesi i vlerësimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në planprogramin e lëndës [Evidencë 29], Rregulloren themelore Kolegjit Universitar Bedër për “Studimet universitare dhe provimet” [Evidencë 3, Neni 100] dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” [Evidencë 35, Neni 26].</p> <p>Njësia përgjegjëse organizon procesin dhe mbarëvajtjen e provimeve finale, duke bërë publike datat e testeve për studentët [Evidencë 94].</p> <p>Pas kryerjes së provimeve dhe korrigjimeve të tyre, personeli akademik bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit [Evidencë 92]. Studentët</p>

	<p>kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura.</p> <p>Në raste kontestimi, pedagogu i lëndës ofron gatishmërinë për të bërë sqarimet e nevojshme.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 56. Shembull, organizimi i provimeve finale Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 92. Shembull Provimi me Celesin e Zgjidhjeve Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për kontrollin dhe shmangien e plagjiaturës dhe kopjeve në provim. Provimet organizohen në salla të mëdha me të paktën dy vëzhgues për të shmangur kopjet [Evidencë 56].</p> <p>Në përputhje me “Rregulloren e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të Parë ” [Evidencë 6], “Rregulloren e disiplinës së Studentëve [Evidencë 33], Guidën e Studentit [Evidencë 28]:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës;</li> <li>2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi;</li> <li>3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit;</li> </ol> <p>Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës dhe informohet instrukturi i kursit dhe Shefi i Departamentit. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi, i cili vlerësohet me 0 pikë.</p> <p>Kolegji Universitar “Bedër” për të shmangur plagjiaturën e mashtrimin, në Rregulloren e disiplinës së studentëve përshkruan masat që merren për këtë shkelje disiplinore në detyrat e kursit, projektet apo tezat e diplomave bachelor e master.</p>




	<p>Për parandalimin e plagjiaturës universitetit përdor softuerin <i>Beder Plagiarism Checker System</i> (<a href="https://pds.beder.edu.al">https://pds.beder.edu.al</a>), i cili është një ndër softet që ofrohet nga Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 56. Shembull, organizimi i provimeve finale Signed.pdf.</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 33. Rregullorja e disiplinës së studentëve Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Brënda afateve të përcaktuara prej Kolegjit Universitar “Bedër”, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike [Evidencë 35, Neni 23], nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar, personeli akademik i lëndës hedh në sistemin BIS notat e secilit student varësisht nga ID-ja e studentit, e cila dihet vetëm prej studentit dhe koordinatori i departmantit për të ruajtur anonimitetin [Evidencë 39]. Kështu pedagogu konverton ID-në në emër të studentit, vetëm pasi notat janë hedhur në sistem.</p> <p>Nga DVV dhe viztita me sekretarinë, RVJ konstatoi se personeli akademik dorëzon pranë koordinatorit të departamentit procesverbalin e rezultateve, si dhe tezat e korrigjuara së bashku me tezat origjinale në një zarf të mbyllur, dhe koordinatori i dorëzon ato pranë sekretarisë mësimore.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e</p>	<p>Bazuar në “Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike” [Evidencë 35, Neni 28], “Guidën e Studentit” [Evidencë 28, fq. 28], studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit, duke dorëzuar një kërkesë ankimimi notash në Zyrën e Sekretarisë Mësimore. Ankesa duhet kryer jo më vonë se 7 ditë kalendrike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit me vendim të Këshillit të Departamentit ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës, në të cilin pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin</p>

<p>ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>përkatës. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.</p> <p><i>RVJ nga vizita në institucion dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion konstaton se programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike" nuk ka pasur raste konkrete të ankimimit.</i></p> <p><b>GVJ konstaton që departamenti nuk ka paraqitur një procedurë në lidhje me ankimimin e notës.</b></p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</u></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p> <p><i>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimimit.</i></p> <p><i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i></p> <p><b>GVJ rekomandon që departamenti të hartojë një procedurë në lidhje me ankimimin e notës.</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike", siç dëshkohet edhe në "Kurrikulat" e lëndës [Evidencë 29] ka për mision:</p> <p><b>1.</b> T'u ofrojë studentëve mundësinë që të marrin dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e informatikës ekonomike;</p>




	<p>2. Të nxisë tek studentët të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të ndryshme të fushës;</p> <p>3. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e informatikës dhe ekonomisë.</p> <p>Për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentit, departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit kujdeset që studenti krahas teorisë, seminareve, projekteve të kryejë edhe praktika profesionale e intershipe në kompanitë e ndryshme në të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi [Evidencë 45] [Evidencë 76].</p> <p>Disa nga aktivitetet e kryera në këtë kuadër janë: (1) Shkolla verore në FinTech, Simulim investimesh në pasuri të paluajtshme; (2) Investim në Bursa; (3) Simulimi Enterprise Resource Planing (ERP); (4) Të mësuarit dhe të nxënimit sipas sfidave – Konkursi SUSILO.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 45. Shembull aplikimi praktike Copy.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë [Evidencë 29], komunikimit dhe ndërveprimit social duke qenë se sektori informatik është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Për më tepër, në fushat e (1) <i>shkencave humane</i>, ku planprogrami ofron lëndë si: “Gjuhë e Huaj” apo lëndë me zgjedhje si “E drejtë Biznesi; (2) <i>shkencave sociale</i>, ku ofrohen lëndë si “Ekonomi”, “Hyrje në Financë”, “Kontabilitet”, “Menaxhim”, “Menaxhim Projektesh” apo “Sjellje Organizative” të cilat e ndihmojnë studentin në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton</p>	<p>Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca</p>

<p>studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara [Evidencë 29], në përputhje kjo edhe me kërkesat e VKM nr. 41 datë 24.01.2018 [Evidencë 91].</p> <p>Direktiva e Kolegjit Universitar “Bedër” urdhëron çdo fakultet që për çdo program studimi të kryhet anketimi i vlerësimit të lëndës, me qëllim vlerësimin cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e saj. [Evidencë 34].</p> <p><i><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</u></i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” [Evidencë 29], është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën profesionale, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e informatikës ekonomike, sikurse pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 40], [Evidencë 30], [Evidencë 78].</p> <p>Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre.</p> <p>Studentët kanë akses në infrastrukturën e nevojshme si [Evidencë 81]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Infrastruktura në Funkcionin e Programit të Studimit;</li> <li>- Shërbimet e Bibliotekës së Universitetit;</li> <li>- Aksesin në laboratorët kompjuterikë;</li> <li>- Aksesin në database JSTOR.</li> </ul> <p>Kolegji Universitar “Bedër” nxit dhe mbështet studentët drejt studimeve të kërkimit shkenocor dhe zhvillimit të ideve inovative. Këtu mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(1) Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si (<a href="https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/">https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/</a>);</li> <li>- AMF për angazhimin e studentëve në investime në bursa;</li> <li>- Angazhime në simulime si ERP, në bashkëpunim me Universitetin Tor Vergata;</li> </ul>



	<p>- Angazhim në <i>Challenge Based Learning</i>: simulim mbi inverstim në tregun e pasurive të paluajshme përmes Fintech etj.</p> <p>(2) Pjesëmarrja e studentëve në konferenca studentore si Konferenca e Universitetit të Korçës (<a href="https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/transf-ormimi-dixhital-ne-kohen-e-sfidave-3/1967">https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/transf-ormimi-dixhital-ne-kohen-e-sfidave-3/1967</a>)</p> <p>(3) Angazhimi në mobilitetet e studentëve në institucionet partnere në kuadër të programit Erasmus [<u>Evidencë 104</u>].</p> <p>Nga ana tjetër Praktika Profesionale, është lëndë e detyrueshme e cila zhvillohet semestrin e tretë. Nëpërmjet bashkëpunimi e marrëveshjeve me institucione qendrore që operojnë në profilin e programit të studimit, institucioni mundëson kryerjen e praktikave profesionale [<u>Evidencë 76</u>].</p> <p><u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 30. Syllabusi i lëndës e-Commerce Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 78. Shembull syllabusi - Programim në Web Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 81. Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 76. Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 104. Shkëmbi i studentëve Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit zhvillon vazhdimisht leksione të hapura, seminare trajnuese, workshop-e, konferenca me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjell tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e informatikës ekonomike, brenda dhe jashtë vendit (<a href="https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/transformimi-dixhital-ne-kohen-e-sfidave-3/1967">https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/transformimi-dixhital-ne-kohen-e-sfidave-3/1967</a>).</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të këtyre aktiviteteve mësimore dhe nxitjes së kërkimit shkencor, departamenti harton një plan aktivitetesh çdo fillim viti akademik [<u>Evidencë 70</u>].</p> <p>Kolegji Universitar “Bedër” në praktikën e tij nxit stafin akademik të kryejë publikime shkencore, duke marrë pjesë në</p>

	<p>mënyrë aktive në konferenca shkencore dhe publikime në revista të indesksuara dhe me faktor impakti [Evidencë 67].</p> <p>Cfare politikash financiare ndiqen për mbështetjen e stafit akademik për kërkim shkencor?</p> <p>Nga dokumentat e vëna në disipozicion, rezulton se kërkimi shkencor është më tepër i orientuar nga konferencat.</p> <p><u>Evidenca nr. 70. Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2023-2024 Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 67. Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023 Signed.pdf</u></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e informatikës dhe ekonomisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Zhvillimi i provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është një proces i mirë organizuar përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullores Themelore të Institucionit [Evidencë 3, Neni 88];</li> <li>- Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë [Evidencë 6, Neni 15];</li> <li>- Rregullores së programit të Studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" [Evidencë 35, Neni 19];</li> </ul> <p>Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi [Evidencë 35, Neni 19].</p>

	<p>Nëse studenti/ja e ka mesatren e notave kumulative (CGPA) nën 3.00, ai duhet t'i nënshtrohet lëndës së Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</p> <p>Nëse studenti/ja e ka mesatren e notave kumulative (CGPA) midis 3.00 dhe 4.00 atëherë ai/ajo mund të zgjedhë që të zhvillojë lëndën e Projektit të Diplomimit.</p> <p>Punimi i diplomimit parashikohet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor.</p> <p><u><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat</b> përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit përcakton listën e temave të diplomave (Projektin e Diplomimit) dhe programet e lëndëve bazë e përgjithshme përfundimtare në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik, në përputhje me Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të parë [Evidencë 6, Neni 15]. Departamenti asiston studentët në përcaktimin e udhëheqësve të diplomave si edhe komisionit të lektorëve përgjegjës për lëndën e provimit përfundimtar [Evidencë 105]. Studentët, pasi njihen me programin e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, asistohen nga koordinatori dhe mentorët e programit të studimit, si dhe pedagogët e lëndëve me informacione, udhëzime dhe materiale në funksion të mbarëvajtjes së tij. Punimi i diplomës përfshihet si lëndë në semestrin e gjashtë në programin mësimor [Evidencë 29]. Gjithashtu udhëzimet gjithëpërfshirëse dhe materialet e nevojshme mund të gjenden në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Manualin e përgatitjes së tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë [Evidencë 60];</li> <li>- Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike [Evidencë 35, Neni 19].</li> </ul> <p><u><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca nr. 105. Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p>




	<p><u>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 60. Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të pare Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në fillim të semestrit të VI, Këshilli i Departamentit harton komisionin e posaçëm për administrimin e provimit final, i cili pasqyrohet në ngarkesën mësimore e më pas miratohet në fakultet dhe në rektorat. Në provimin përfundimtar të mbrojtjes së diplomës përfshihen lëndët karakterizuese të programit përkatës, pra, të gjitha lëndët e veprimtarisë B. Mund të përfshihen lëndë të kategorisë C në ato raste kur janë të profilit profesional të programit.</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion një grup pyetjesh dhe në bazë të tyre hartohet provimi përfundimtar [Evidencë 105].</p> <p><u>Evidenca nr. 105. Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit ka hartuar një procedurë për përzgjedhjen e temës së diplomës nga ana e studentëve, ku në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik të vitit të tretë, Departamenti shqyrton propozimet e studentëve mbi temat dhe garanton që temat të jenë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe profilit e ngushtë akademik dhe profesional të lektorëve udhëheqës, i cili përcaktohet me vendim të këshillit të departamentit.</p> <p>Pas përfundimit të këtij procesi, udhëheqësi ndihmon studentin në zhvillimin e idesë fillestare, kryerjen e studimit të literaturës, përcaktimin e metodologjisë, implementimin dhe testimin e rezultateve. Procesi i paraqitjes përfundimtare të temës së diplomës përcaktohet në "Manualin për përgatitjen e tezës së diplomës" [Evidencë 60]. Për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit të punimi të diplomës institucioni ka hartuar një formular raportimi periodik në lidhje me ecurinë e saj [Evidencë 90].</p> <p><u>Evidenca nr. 60. Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të pare Signed.pdf</u></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p><u>Evidenca nr. 90. Formulari i vlerësimit te tezës Signed.pdf</u></p> <p>Nga vizita në institucion, takimi me RVB, takimi me studentët, GVJ konstaton se: Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën shkencore për të inkurajuar studentët drejt kërkimit shkencor, praktikave, apo kryerjeve të implementimeve apo testimeve të ndryshme në lidhje me informatikën ekonomike. Infrastruktura shkencore e ofruar përfshin [Evidencë 81]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Infrastruktura në funksion të programit të studimit;</li> <li>- Shërbimet e bibliotekës;</li> <li>- Biblioteka online (JSTOR);</li> <li>- Shërbimet e IT-së;</li> <li>- Aksesit në burime online të revistave shkencore;</li> <li>- Programe softuerike specifike të nevojshme për lëndët e tyre.</li> </ul> <p>Institucioni gjatë periudhës së provimeve dhe punimit të tezës së diplomës mban të hapur aksesin në laboratorët e kompjuterave dhe bibliotekë.</p> <p><u>Evidenca nr. 81. Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit ngre komisionin e vlerësimit, i cili përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë dhe miratohet nga këshilli i departamentit.</p> <p>Provimi i formimit apo teza e diplomimit vlerësohet me notë, njëlloj si lëndët e tjera. Në provimin përfundimtar, secila lëndë ka peshën e saj mbi bazën e krediteve përkatëse në vlerësimin e përgjithshëm prej 100 pikësh [Evidencë 6, Neni 19].</p> <p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet me prezantim para komisionit, dhe vlerësohet me notë, e cila arkivohet pranë koordinatorës së departamentit dhe u shfaqet studentëve në sistemin BIS.</p> <p><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti, i cili ka përfunduar me sukses të gjitha lëndët e programit të studimit dhe ka përmbytur të gjitha detyrimet e parashikuara në programin e studimit, pajiset me diplomë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, të</p>




<p>studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Kolegjit Universitar “Bedër”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [Evidencë 6, Neni 28].</p> <p>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion diploma, suplementi i diplomës dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit, bazuar në Rregulloren Themelore [Evidencë 3, Neni 109].</p> <p><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Ruajtje dhe arkivimi i të dhënave është parashikuar në Rregulloren Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër” [Evidencë 3, Neni 47].</p> <p>Zyra e Regjistrimit [Evidencë 18] dhe Akriva e Kolegjit Universitar “Bedër” [Evidencë 9, Neni 6], sipas detyrimeve ligjore ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të të dhënave të diplomimit dhe performanës së studentit si: dosja e studentit, rregjistri themeltar, rregjistri i arritjeve akademike etj. dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p> <p><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 18. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore Signed.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 9. Rregullorja e Arkivës Signed.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit përfundimtar/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kriteret e tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike” në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, të Kolegjit Universitar “Bedër”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p>X</p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																																													
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																												
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri GVJ shyrtoi dokumentacionin e dorzuar [RVB – Shtojca: Tabelat Përmbledhëse] si dhe diskutoi me stafin e angazhuar në këtë program studimi. GVJ konstaton se në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë angazhuar pedagogë efektivë dhe pedagogë me kontratë, ku spikasim ekspertë të fushës të cilët punojnë në institucione të rëndësishme në vend. Vëmë re se ky staf i përfshirë ka kulifikimin dhe eksperiencën e duhur në përputhje me programin, natyrën dhe veçoritë e tij [Evidenca nr. 54]. Në lidhje me titujt dhe gradat e stafit, duke ju referuar të dhënave të Tabelës 6.1, kemi:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi akademik i programit të studimit</th> <th colspan="2">2021 – 2022</th> <th colspan="2">2022 – 2023</th> <th colspan="2">2023 – 2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr në proces</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>2</b></td> <td><b>10</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>13</b></td> <td><b>8</b></td> </tr> </tbody> </table>						Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	0	0	0	0	0	0	Prof.As.Dr	0	0	1	0	0	0	Dr/PhD	2	1	2	2	4	1	Dr në proces	3	0	3	0	5	1	Msc	2	1	4	5	4	6	<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>13</b>	<b>8</b>
	Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024																																																							
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																						
	Prof.Dr	0	0	0	0	0	0																																																						
	Prof.As.Dr	0	0	1	0	0	0																																																						
	Dr/PhD	2	1	2	2	4	1																																																						
	Dr në proces	3	0	3	0	5	1																																																						
	Msc	2	1	4	5	4	6																																																						
	<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>13</b>	<b>8</b>																																																						
	<p>Konstatojmë se pavarësisht kulifikimit të stafit në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e programit të studimit, ka një mungesë të përfshirjes së kategorisë Profesor, <i>mendojmë që është e nevojshme që në këtë program të angazhohen pedagogë të kategorisë Profesor si dhe të rekrutohen më shumë pedgogë me gradën shkencore Doktor</i>. Këta do të jenë një vlerë e shtuar për rritjen e cilësisë në mësimdhënie në këtë program studimi. Përsa i përket raportit të numrit të PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program referuar të dhënave [Tabela 6 dhe 7, Shtojcat e RVB], në mënyrë më të detajuar kemi:</p>																																																												

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mësim 9 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK (në raportet 77%/23%)</li> <li>• Për vitin akademik 2022 – 2023 kanë dhënë mësim 17 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 7 PAK (në raportet 58%/41%)</li> <li>• Për vitin akademik 2023 – 2024 kanë dhënë mësim 21 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 8 PAK (në raportet 61%/39%)</li> </ul> <p>Megjithatë referuar shifra të ngarkesës mësimore të stafit të angazhuar në këtë program studimit [Tabela 4, Shtojcat e RVB], konstatohet se PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore të programit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi [VKM Nr. 418 datë 10.5.2017], përkatësisht ky raport është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• PAE mbulon 79% të ngarkesës mësimore në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike</li> <li>• PAK mbulon 21% të ngarkesës mësimore në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike</li> </ul> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 54. CV -të e stafit akademik Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe diskutimin gjatë vizitës, me Zyrën e Burimeve Njerëzore, por edhe me stafin e programit, GVJ konstaton se institucioni garanton rekrutimin e stafit akademik efektiv, përmes kontratave të punës [Evidenca nr. 95]. Zyra e Burimeve Njerëzore konfirmon se pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë bërë sipas legjislacionit në fuqi, kjo gjë u konstatua edhe gjatë konsultimit me dosjet e personelit që u zgjodhën në mënyrë të rastësishme. Bazuar tek të dhënat e tabelave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, si dhe nga biseda me një pjesë prej tyre, GVJ konstatoi se stafi efektiv ka qëndrueshmëri në këtë institucion, dhe tashmë ka vite i punësuar aty.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">Evidenca nr. 95. Kontratë pune individuale me kohë të plotë e stafit akademik Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” ndjek procedura standarde të rekrutimit të personelit, të cilat i ka përcaktuar në Statutin e vet (Neni 61, 62, 63) si dhe në Rregulloren Themelore (Neni 26, 27). Sipas këtyre procedurave kriteret [Evidenca nr. 116] e rekrutimit përcaktohen nga departamenti, bazuar në nevojat e</p>




<p>publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>tij, dhe pas miratimit nga dekani dhe rektori, përcillen për publikim në Drejtorinë Rajonale të Punësimit [Evidencë nr. 23, 83], si dhe në faqen e web-it të institucionit dhe në rrjetet sociale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se këto procedura janë të regullta dhe ndiqen në përputhje me rregulloret. Kriteret që vendosen synojnë të përzgjedhin personelin e duhur me kualifikimet e përshtatshme në përputhje me strukturën dhe lëndët e këtij programi studimi. Gjatë takimit me drejtuesin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, GVJ u informua që pavarësisht mungesës së aplikimeve të pedagogëve me tituj akademik (Profesor), ata janë përpjekur që stafi i zgjedhur të jetë në përputhje me kriteret dhe të motivohet dhe mbështetet për kualifikimin e mëtejshëm akademik.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 116. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 83. Shkresa dërguar Drejtorisë Rajonale të Punësimit Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 23. Procedura e rekrutimit të stafit akademik Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me përgjegjësën e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit GVJ u informua që departamenti ka angazhuar një personel ndihmës akademik, i cili është në mbështetje të veprimtarisë së mësimdhënies në departament. Kjo gjë evidentohet edhe në Tabelat Përmbledhëse (Tabela 2.2, 2.3). Gjithashtu për zhvillimin e orëve të laboratorit ose lëndëve që lidhen me përdorimin e teknologjisë së informacionit, institucioni angazhon personel ndihmës nga Zyra e Teknologjisë së Informacionit sipas nevojave.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 8. Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për</p>	<p>GVJ konstaton se KU "Bedër" mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit të tij akademik dhe administrativ si dhe përgjegjësit të departamentit i cili është personi përgjegjës për këtë program studimit, në një bazë të dhënash fizike dhe elektronike. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, ku disponohen dosjet personale të stafit akademik si edhe baza elektronike e të dhënave. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën përditësime të bazës elektronike të</p>

<p>mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Gjithashtu edhe vetë anëtarët e stafit mund të bëjnë përditësim të të dhënave personale duke përdorur sistemin informativ të universitetit, BIS. GVJ u njoh me përmbajtjen e dy dosjeve të rastësishme, në të cilat ndodheshin dokumenta si: librezat e punës, leja e angazhimit nga institucioni i punës për pedagogët me kontratë, diplomat, lista e notave, CV, librezat shëndetsore, raportit mjeko-ligjor, karta e identitetit, etj. Angazhimi i personelit akademik dhe ngarkesa e tij përcaktohet çdo fillim semestri në njësinë bazë sipas nevojave të saj, dhe miratohet nga Dekani. Të dhënat e mbledhura respektojnë legjislacionin që lidhet me mbrojtjen e të dhënave personale, duke pasur edhe dakordësinë e çdo anëtari të stafit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">Evidenca nr. 20. Udhëzim për ngarkesën mësimore Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU “Bedër” ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me 26 institucione në vend [Shtojca: Tabela 5], tek të cilat adresohen studentët për realizimin e praktikave profesionale. Udhëheqësi për praktikën dhe diplomën caktohet nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi. Pasi marrin konfirmimin për pedagogun udhëheqës, studentët plotësojnë një formular pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës. Kjo zyrë bën lidhjen e studentëve me kompanitë me të cilat institucioni ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave ose miraton kompanitë të cilat mund ti kenë zgjedhur vetë ata. Zyra pajis studentët me dokumentat përkatëse që studenti duhet të dorzojë në përfundim të praktikës. Këto dokumenta studenti i dorzon pranë pedagogut udhëheqës dhe një kopje pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës [Evidenca nr. 55]. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët e vitit të 3-të të këtij programi studimi, ata konfirmuan angazhimin e pedagogëve udhëheqës në ndjekjen e praktikës dhe të diplomës.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 55. Procedura e praktikës profesionale Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në</p>	<p>Sikurse e theksuam edhe në kriteret më sipër, Zyra e Planifikimit të Karrierës është përgjegjëse për bashkëpunimin me kompanitë në të cilat dërgohen studentët për zhvillimin e</p>

<p>realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>praktikave profesionale. Zyra mban kontakte me ta për të qenë në korrent të mbarëvajtjes së praktikës apo plotësimin të dokumentacionit të studentëve në përfundim të saj. GVJ shqyrtoi disa kopje të dokumentave të plotësuar të praktikës. Studentët pohuan gjithashtu se kanë pasur një bashkëpunim të mirë me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe ishin pritur mirë ndihmuar nga stafet e kompanive pranë të cilave kishin zhvilluar praktikën.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u>Evidenca nr. 55. Procedura e praktikës profesionale Signed.pdf</u>  <u>Evidenca nr. 45. Shembull aplikimi praktike Copy.pdf</u></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë angazhuar pedagogë efektivë dhe pedagogë me kontratë, ku spikasin ekspertë të fushës të cilët punojnë në institucione të rëndësishme në vend. Konstatohet se pavarësisht kualifikimit të stafit në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e programit të studimit, ka një mungesë të përfshirjes së kategorisë Profesor, rekomandojmë që në këtë program të angazhohen pedagogë të kategorisë Profesor si dhe të rekrutohen më shumë pedagogë me gradën shkencore Doktor. Konstatohet se PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore të programit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni garanton rekrutimin e stafit akademik efektiv, përmes kontratave të punës. Gjithashtu stafi efektiv ka qëndrueshmëri në këtë institucion, dhe tashmë ka vite i punësuar aty.</p> <p>Kolegji Universitar "Bedër" ndjek procedura standarde të rekrutimit të personelit, të cilat i ka përcaktuar në Statutin e vet si dhe në Rregulloren Themelore. GVJ konstaton se këto procedura janë të rregullta dhe ndiqen në përputhje me rregulloret.</p> <p>GVJ konfirmon që institucioni ka angazhuar personel ndihmës akademik, i cili është në mbështetje të veprimtarisë së mësimdhënies në departament.</p> <p>GVJ konfirmon se KU "Bedër" mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit të tij akademik dhe administrativ si dhe përgjegjësit të departamentit i cili është personi përgjegjës për këtë program studimit, në një bazë të dhënash fizike dhe elektronike.</p> <p>GVJ konfirmon që studentëve ju caktohet një pedagog udhëheqës që i ndjek ata dhe i udhëzon për zhvillimin e praktikës profesionale dhe tezës së diplomës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar tek të dhënat e konsultuara në Tabelat Përmbledhëse (Tabela 16) GVJ konstaton që institucioni siguron mjediset të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, përgjegjës për këtë program studimi. Nga të dhënat rezultojnë që hapësira në dispozicion të studentëve është 3.85 m<sup>2</sup>/student, gjë që është në përputhje me standardin e kërkuar. GVJ vizitoi gjithashtu mjediset e institucionit, klasat, labororet, bibliotekën dhe konfirmon këtë fakt. Në këtë fakultet janë në shërbim të realizimit të procesit mësimor për të gjitha programet e studimit 4 salla leksionesh, 9 salla seminaresh, 3 laboratorë informatike, 1 sallë interneti, 1 sallë për praktikat lëndore, dhe mjediset e tjera ndihmëse, si biblioteka, salla aktivitetesh promovuese, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> <u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, labororë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e institucionit, GVJ konstatoi që klasat e seminareve dhe leksioneve janë të pajisura me video-projektor, internet wireless falas, tabela interaktive që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Gjithashtu labororet kanë kompjutera të pajisur me software në shërbim të lëndëve specifike të këtij programi studimi.</p> <p>Tre labororët janë me parametrat e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Laboratori PC LAB I është i pajisur me 27 kompjutera workstation HP Z440 MT, me procesor Xeon 1650 V3 - Hexa Core, me memorie 16GB DDR4 SDRAM PC4 21000Hz, SSD 240GB, kartë grafike të dedikuara NVIDIA Quadro K2200 GDDR5 SDRAM 4GB dhe HDD 500GB</li> <li>Laboratori PC LAB II përbëhet nga 26 Kompjutera me parametra më të ulta, por të mjaftueshëm për programet të cilët kanë për qëllim kryesor programet për përpunimin e tekstit, imazheve ose kodimin. Kompjuterat janë të modelit: HP 500B MT, me procesor të modifikuar Q8400 2 Quad 2.66GHz 4MB</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>cache 1333MHz, memorie RAM 4GB DDR3 dhe grafikë Intel Graphics Media Accelerator X4500</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Laboratori Media LAB I është i pajisur me 16 kompjutera HP EliteDesk Pro 600 G2 SFF, me procesor Intel(R) Core (TM) i5-6600 CPU @ 3.30GHz 3.31 GHz, me memorie 16GB DDR4, SSD 256GB</li> <li>• Laboratori Media lab II është i pajisur me 41 PC në total dhe po ashtu me 42 monitor në total. Kompjuterat dhe monitorët janë dy modelesh Modeli i parë janë 16 kompjutera workstation HP Z440 MT, me procesor Xeon E5-1650 V4 - Hexa Core, me memorie 16GB DDR4 SDRAM PC4 21000Hz, SSD 256GB, kartë grafike të dedikuar NVIDIA Quadro M2000 SDRAM 4GB. Monitorët e kësaj salle janë të modelit HP Elite Display, E241i, 23 inch, me rifreskim 60Hz, rezolucion 1920x1200, me teknologji ekrani IPS w/LED backlight dhe contrast dinamik 5.000.000:1</li> <li>• Modeli i dytë janë 25 kompjutera workstation HP 290 G4 Microtower PC, me procesor Intel (R) Core (TM) i5-10500 CPU @ 3.10 GHz, 3.10 GHz, me memorie 16GB DDR4, SSD 256GB, kartë grafike të dedikuar NVIDIA Quadro 4GB. Monitorët e kësaj salle janë të modelit HP V24i FHD, 23.8 inch, me rifreskim 60Hz, rezolucion 920 x 1080, me teknologji ekrani IPS w/LED backlight dhe contrast dinamik 5.000.000:1.</li> </ul> <p>Gjithashtu laboratorët kanë mjete për demonstrimin e arkitekturës së kompjuterave, specifike për lëndët e këtij programi studimi.</p> <p>GVJ konkludon se infrastruktura laboratorike është e plotë dhe e përshtatshme për aftësimin teorik e praktik të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 81. Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, institucioni siguron përdorimin e 3 laboratoreve dhe një media lab në funksion të këtij programi studimi. Kompjuterat janë të pajisur me programe të përdorimi të përgjithshëm për përpunimin e tekstit, spreadsheet-eve, si dhe me programe të tjera për kodimin, dhe përpunimin e të dhënave.</p>

<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton që institucioni siguron mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, përgjegjës për këtë program studimi. Nga të dhënat rezulton që hapësira në dispozicion të studentëve është 3.85 m<sup>2</sup>/student, gjë që është në përputhje me standardin e kërkuar.</p> <p>GVJ konkludon se infrastruktura laboratorike është e plotë, si nga ana hardware dhe software dhe e përshtatshme, për aftësimin teorik e praktik të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter GVJ shqyrtoi syllabuset e lëndëve dhe konstaton se në përgjithësi të gjitha lëndët përdorin literaturë të përditësuar dhe bashkëkohore. Literatura e përzgjedhur garanton marrjen e njohurive të nevojshme për këtë program studimi. Në takimin me pedagogët u informuam që kjo literaturë është mbështetur në programet e studimit të ngjashme në universitete ndërkomëtare. Literatura është në gjuhën angleze, meqënëse edhe programi zhvillohet në gjuhën angleze. Kjo e ka lehtësuar më shumë përzgjedhjen e një literature të plotë dhe të përshtatshme me trendet e fundit të shkencës. Literatura mund të aksesohet nëpërmjet librave fizikë që disponohen në bibliotekë, por edhe në rrugë digjitale.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me përgjegjësen e departamentit dhe pedagogët, u pohua se çdo fillim viti akademik, titullari i lëndës dorëzon programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Kjo mbështetet edhe në evidencat e shqyrtuara nga GVJ [Evidenca nr. 112]. Gjithashtu çdo fillim viti pedagogët diskutojnë apo bëjnë kërkesë për përditësimin e literaturës që përdorin, nëse e shohin të arsyeshme [Evidenca nr. 86]. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi një numër titujsh, që u evidentuan</p>

	<p>dhe gjatë shqyrtimit të syllabuseve. Shumica e librave i përkasin 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 112. Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 86. Kërkesa për literaturë Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka një bibliotekë të pasur dhe të dedikuar për studentët dhe stafin akademik me 24 poste leximi dhe 8 kompjutera në funksion të saj [Tabelat Përmbledhëse: Tabela 17]. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konstatoi se kjo bibliotekë frekuentohej shumë shpesh nga studentët, atje takuam disa studentë shqiptarë dhe të huaj të cilët na treguan se ishin shumë të kënaqur me shërbimin e bibliotekës. Të gjithë studentët kishin akses të barabartë në burimet fizike dhe online të bibliotekës. Punonjësja që kujdesej për bibliotekën i shërbente me përkushtim të madh studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i></u>  <u><a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162</a></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e KU “Bedër”, dhe bisedës me punonjësën e bibliotekës, GVJ u njoh me fondin e pasur të kësaj biblioteke, i cili përbëhej kryesisht nga libra në gjuhën angleze, në gjuhë të tjera si edhe shqip. GVJ u informua se koleksioni i bibliotekës është pasuruar me tituj të ndryshëm në sajë të fushatave për blerjen dhe donacione nga institucione dhe individë. Titujt janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit administrativ dhe akademik. Biblioteka aktualisht numëron 22600 tituj shkencorë, 26000 libra shkencorë, 166 monografi, 48 revista shkencore, etj. Gjithashtu biblioteka është e abonuar në platforma online, si JSTOR që ofron përdorimin e një fondi të pamasë të artikujve në revistat shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Nga konstatimet e mësipërme GVJ konkludon se institucioni ka një fond të pasur fizik dhe elektronik të literaturës që mbështet programin mësimor dhe veprimtaritë e tjera mësimore sipas natyrës e specifikës së programeve të studimit që ofron.</p> <p>Biblioteka disponon katalogun e saj elektronik, i cili është i aksesueshëm në <a href="http://library.beder.edu.al">http://library.beder.edu.al</a>.</p> <p><i>Evidenca:</i></p>

	<p><a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162</a></p> <p><i>Evidenca nr. 26. Marrëveshja për akses në JSTOR Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse e evidentuam edhe në kriterin më sipër, institucioni është i abonuar në paltformën JSTOR, duke ju ofruar të gjithë studentëve dhe pedagogëve akses të pakufizuar dhe falas, të cilët mund të hyjnë nëpërmjet email-it institucional në link-un <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a>. Gjithashtu GVJ u informua që institucioni mundëson edhe aksesin në Book Academic Collection. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, përgjegjës për këtë program studimi është i abonuar edhe në revistën Monitor dhe Business Magazine, duke ju mundësuar akses online dhe fizik studentëve dhe stafit akademik. [Tabelat Përmbledhëse: Tabela 17].</p> <p><i>Evidenca:</i>  <i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 26. Marrëveshja për akses në JSTOR Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e KU “Bedër” ka në dispozicion të studentëve 8 kompjutera në sallë të cilët studentët mund ti shfrytëzojnë për të aksesuar platformat online që ju mundëson institucioni, si dhe mund të konsultojnë fondin fizik të bibliotekës nëpërmjet <a href="http://library.beder.edu.al">http://library.beder.edu.al</a>. Gjithashtu aksesin në internet është i pakufizuar për studentët dhe stafin gjë i lejon ata të përdorin edhe mjetet e tyre mobile (laptop, tablet, etj.). GVJ konstaton një organizim shumë të mirë të shërbimit elektronik të bibliotekës, e cila ofron linkun për platformën online JSTOR; librari të ndryshme online si Open Library, Canadian Library, Digital Library for International Research, etj; revista online si Magazine Rack; revista dhe artikuj online si Oxford Open, Directory of Open Access Journals; motorë kërkimi akademikë si Archival Research Catalogue, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162</a>  <a href="https://library.beder.edu.al/electronic-services">https://library.beder.edu.al/electronic-services</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u njoh me oraret e saj. Biblioteka është e hapur nga ora 8.30 - 19.00. Studentët pohuan që orari i bibliotekës është i përshtatshëm për të përballuar nevojat e tyre dhe për të mos ndikuar tek mbarëvajtja mësimore. Përgjegjësja e bibliotekës na informoi se biblioteka ishte në dispozicion të studentëve në çdo kohë edhe jashtë orarit të shpallur dhe në fundjavë. Nëse studentët kishin nevojë atyre ju vihej në dispozicion çelësi, duke pasur një besim dhe</p>

<p>nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>mirëkuptim midis tyre. Përgjegjësja e bibliotekës na informoi se studentët e KU "Bedër" që frekuentonin bibliotekën ishin anëtarë të rregullt dhe me shumë përgjegjësi.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/biblioteka-7-7/7/162</a>  <i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Sikurse e evidentuam edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, GVJ konstaton se departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit përgjegjës për këtë program studimi, realizon në fillim të çdo viti diskutime me pedagogët përgjegjës të lëndëve që mbulojnë programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, duke nxjerrë në pah nevojat për përditësimin dhe shtimin e literaturës në funksion të këtij program studimi [Evidenca nr. 86]. Në bazë të kërkesave që vijnë nga departamentet, KU "Bedër" parashikon fonde për blerjen e literaturës së re, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar.</p> <p>Gjithashtu GVJ u informua se fondi i literaturës është shtuar edhe nëpërmjet donacioneve të ndryshme apo fushatave që promovojnë librin.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <i>Evidenca nr. 112. Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve Signed.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 86. Kërkesa për literaturë Signed.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se literatura e përzgjedhur për këtë program studimi garanton marrjen e njohurive të nevojshme dhe të plota. Literatura është në gjuhën angleze, meqënëse edhe programi zhvillohet në gjuhën angleze. Megjithatë gjendet edhe literaturë në gjuhë të tjera si dhe në shqip.</i></p> <p><i>Çdo fillim viti pedagogët diskutojnë apo bëjnë kërkesë për përditësimin e literaturës që përdorin, nëse e shohin të arsyeshme.</i></p> <p><i>Të gjithë studentët kishin akses të barabartë në burimet fizike dhe online të bibliotekës.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se institucioni ka një fond të pasur fizik dhe elektronik të literaturës që mbështet programin mësimor dhe veprimtaritë e tjera mësimore sipas natyrës e specifikes së programeve të studimit që ofron.</i></p> <p><i>GVJ konstaton një organizim shumë të mirë të shërbimit</i></p>



	<p>elektronik të bibliotekës.</p> <p>Studentët pohuan që orari i bibliotekës është i përshtatshëm për të përballuar nevojat e tyre dhe për të mos ndikuar tek mbarëvajtja mësimore.</p> <p>KU "Bedër" parashikon fonde për blerjen e literaturës së re, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit që është "Bedër Information System (BIS)". Nëpërmjet tij sigurohet ruajtja, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentëve si dhe gjenerimi i raporteve statistikore që nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Çdo student pajiset me kredencialet e tij personale dhe mund ta aksesojë sistemin nga çdo pajisje elektronike në çdo kohë <a href="https://bis.beder.edu.al/">https://bis.beder.edu.al/</a>. BIS ju ofron studentëve një ndërfaqe e cila jep detaje në lidhje me lëndët, notat, pjesmarrësit në mësim, si dhe informacione të tjera të personalizuara si pagesat apo informacion personal të studentit. Sekretaria ruan të dhënat për studentët në sistemin elektronik BIS si dhe në regjistrat fizikë. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u njoh me regjistrat përkatës: Rregjistrin Themeltar, Rregjistrin e Arritjeve Akademike dhe Rregjistrin e Diplomave. Për këtë program studimi të gjithë të dhënat e studentëve ishin regjistruar korrekt në dy regjistrat e parë, ndërkohë që meqënëse programi ka vetëm tre vite akademike që është hapur, nuk ka akoma studentë të diplomuar.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u>Evidenca nr. 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS) Signed.pdf</u>  <a href="https://bis.beder.edu.al/">https://bis.beder.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerzore bën ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin e angazhuar në realizmin e programit mësimor.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



<p>aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon dosjet fizike të cilat u verifikuan gjatë takimit të GVJ në institucion. Në dosje ndodhen dokumenta të tilla si: librezat e punës, leja e angazhimit ose vetëdeklarim për stafin PAK, diplomat, listat e notave, cv, librezat shëndetsore dhe raporti mjeko-ligjor, etj. Përveç dosjeve kjo zyrë është e lidhur edhe me sistemin elektronik BIS, ku hedh të dhënat për të gjithë stafin në sistem.</p> <p>Sistemi i informacionit BIS është një sistem i integruar me module dhe bën të mundur qarkullimin e informacionit midis njësive të KU “Bedër” duke përfshirë stafin akademik, administrativ dhe studentët.</p> <p>Të gjitha njësitë kanë llogari personale dhe akses në informacione sipas profilit dhe detyrave të gjithsecilit: Koordinatorët kanë akses në lidhje me caktimin e lëndëve dhe monitorimin e aktivitetit akademik; Zyra e Sekretarisë Mësimore ka module për të menaxhuar informacionin personal dhe akademik të studentëve; Zyra e Financës dhe Çështjeve Administrative ka module për të menaxhuar dhe përcjellë informacionin financiar të studentëve; Zyra e Burimeve Njerëzore ka module për të menaxhuar të dhënat e stafit; Pedagogët mund të shohin lëndët që japin, mund të hedhin notat, mungesat, etj; Këshilltarët Akademikë kanë akses në lëndët që regjistrohen studentët, dhe i këshillojnë ata për çdo gjë që lidhet me përzgjedhjen e tyre dhe mbarëvajtjen mësimore.</p> <p>Secili pjesmarrës ka akses të dedikuar sipas funksionit apo statusit të tij.</p> <p>Sistemi mundëson sinkronizimin dhe transferimin e të dhënave nga njëra njësi tek tjetra në kohë reale, dhe sipas kërkesave të drejtuesve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p><i>Evidenca:</i>  <u>Evidenca nr. 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</u>  <u>Signed.pdf</u>  <a href="https://bis.beder.edu.al/">https://bis.beder.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik dhe administrativ garantohej përmes sistemit BIS. Të gjithë përdoruesit kanë akses në të dhënat sipas rolit që kanë, për ti përditësuar apo vetëm për ti lexuar.</p> <p>Gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u konfirmua se sistemi BIS siguron edhe gjenerimin e raporteve që i nevojiten sekretarisë mësimore për raportimet pranë strukturave</p>

<p>në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>menaxhuese të institucionit, në lidhje me frekuentimin, rezultatet, etj [Evidenca nr. 57].</p> <p><i>Evidenca:</i> <u><i>Evidenca nr. 57. Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore Signed.pdf</i></u></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>KU “Bedër” ka një faqe zyrtare web-i e <a href="https://www.beder.edu.al/">https://www.beder.edu.al/</a> cila është e publikuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në të jepet informacion i bollshëm rreth institucionit dhe mënyrës së organizimit të tij akademik, informacion në lidhje me pranimet e reja, studentët dhe kërkimin shkencor. Gjithashtu në faqe gjenden informacione të hollësishme për njësitë kryesore dhe bazë si dhe për programet e studimit që ofrohen prej tyre. Për çdo departament ka informacion për stafin, aktivitetet e ndryshme në funksion të mësimdhënies dhe aktivitete të tjera kulturore dhe sociale.</p> <p>Specifikisht për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ka informacion të detajuar rreth programit, planit mësimor dhe kalendarit të mësimimit.</p> <p>Të gjitha informacionet janë lehtësisht të aksesueshme në Internet për këdo që është i interesuar.</p> <p><i>Evidenca:</i> <a href="https://www.beder.edu.al/">https://www.beder.edu.al/</a> <a href="https://ecobus.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-informatike-ekonomike-6/675/676">https://ecobus.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-informatike-ekonomike-6/675/676</a></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni disponon një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit që është “Bedër Information System (BIS)”. Nëpërmjet tij sigurohet ruajtja, administrimi dhe përpunimi i të gjitha të dhënave të studentëve si dhe gjenerimi i raporteve statistikore që nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Sistemi i informacionit BIS është një sistem i integruar me module dhe bën të mundur qarkullimin e informacionit midis njërive të KU “Bedër” duke përfshirë stafin akademik, administrativ dhe studentët. Secili pjesmarrës ka akses të dedikuar sipas funksionit apo statusit të tij. Sistemi mundëson sinkronizimin dhe transferimin e të dhënave nga njëra njësi tek tjetra në kohë reale, dhe sipas kërkesave të drejtuesve.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**  
**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar KU “Bedër” ka statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës, dhe financiarisht është pjesë e fondacionit “Hafiz Ali Korça”. Gjatë shqyrtimit të dokumentave të dorëzuara në dosje, GVJ shqyrtoi projekt buxhetin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, ku paraqiten vetëm shpenzimet sipas programeve të studimit që ai ofron. GVJ nuk gjen ndonjë dokument specifik në lidhje me llogaritjen e kostos mesatare për një student. Në Evidencën nr. 66 paraqitet kosto për student në këtë program studimi 2250 Euro, por nuk jepen detaje të llogaritjes së saj. Megjithatë në dokumentat e shqyrtuara GVJ konstaton se njësia bazë ka hartuar një plan buxhet me zërat respektivë për mbulimin e të gjithë aktiviteteve të departamentit, përfshirë edhe programet e studimit që ajo ofron. Ky plan është pjesë e raportit financiar të institucionit [Evidenca nr.79].</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 79. Projekt buxheti i departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 66. Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit. Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi Projekt Buxhetin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit për vitin 2023 – 2024 [Evidenca nr. 79], konstaton se ky projekt përmban shpenzimet për pagat, shpenzimet për kërkimin shkencor, shpenzime të tjera operative, shpenzimet për materialet kompjuterike, shpenzimet për promovimin dhe marketingun, shpenzimet për aktivitetet studentore, shpenzimet për blerjen e literaturës së re, etj. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të të dhënave të tabelës 18 të tabelave përmbledhëse [RVB], GVJ konstaton se institucioni harton planin financiar vjetor të të ardhurave, ku janë të përfshira të ardhurat të cilat vijnë kryesisht nga grantet për kërkim dhe kontratat, konsulencat, tarifat e shkollimit të studentëve dhe donacionet.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 79. Projekt buxheti i departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit Signed.pdf</i></u>  <u><i>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</i></u></p>

dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në bazë të RVB dhe takimit me drejtuesin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, GVJ u informua se institucioni punëson një kontabilist të miratuar për të bërë auditin e situatës financiare të fondacionit “Hafiz Ali Korça”, i cili harton një raport që ruhet pranë Fondacionit. GVJ u informua që ky raport gjendet në zyrën e financës të institucionit. <i>Megjithatë në dokumentat e shqyrtuara në dosjen e vetë vlerësimit, GVJ nuk gjeti një dokument të tillë.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas RVB dhe informacionit që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, KU “Bedër” harton raportin institucional të të ardhurave dhe shpenzimeve, të detajuar deri në nivel të njësisë bazë. Ky raport në fund të çdo viti akademik i paraqitet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në të paraqitet buxheti i vitit të kaluar, buxheti i ardhshëm dhe buxheti afatmesëm.  <i>Evidenca:</i> <i><u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u></i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me drejtuesin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, GVJ u informua se KU “Bedër” garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e të gjitha programeve të studimit që ai ofron, për shkak të mbështetjes financiare të donatorëve të Fondacionit “Hafiz Ali Korça”. Gjithashtu edhe tarifat e studimit janë një e ardhur e qëndrueshme për mbështetjen nga ana financiare të shpenzimeve të programeve të studimit. Megjithatë në dokumentat e shqyrtuara, GVJ nuk gjen një dokument përmbledhës, ku të bëhet një analizë e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel programi studimi. GVJ sugjeron paraqitjen e detajuar në një raport financiar, të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve për programin e studimit, apo kostot mesatare për një student.  <i>Evidenca:</i> <i><u><a href="#">Evidenca nr. 79. Projekt buxheti i departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit Signed.pdf</a></u></i> <i><u><a href="#">Tabela 18: RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u></i>
<b>Konkluzione</b>	<i>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar KU “Bedër” ka statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës, dhe financiarisht është pjesë e fondacionit “Hafiz Ali Korça”.</i>

	<p>GVJ konstaton se KU "Bedër" garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e të gjitha programeve të studimit që ai ofron, për shkak të mbështetjes financiare të donatorëve të Fondacionit.</p> <p>GVJ sugjeron paraqitjen e detajuar në një raport financiar, të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve për të reflektuar edhe kostot e programeve të studimit, apo kostot mesatare për një student.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>KU "Bedër" harton dhe ndjek me përpikmëri Rregulloren Themelore (Kreu 10) dhe Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë për Pranimin e Studentëve në Programet e Studimit të Ciklit të Parë. Kriteret e pranimin janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/20215 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Në këto rregullore janë përcaktuar qartë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni jo vetëm për pranimin e studentëve, por edhe transferimet, largimet, dhe mbulimin e gjithë ciklit të plotë akademik nga hyrja në dalje.</p> <p>Përveç rregulloreve të sipërcituara, studentët kandidatë i gjejnë këto procedura edhe në faqen e web-it të institucionit <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151</a> dhe në Guidën e studentit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></p>



	<p><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregulloreve, statutit dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek KU “Bedër” për regjistrimin e studentëve dhe gjithë shkollimin e tyre deri në diplomim, garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në Nenin 98 të Statutit. Gjithashtu në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë janë përcaktuar në Nenin 33, 34, 35, 36 edhe mundësitë për regjistrimin e studentëve me aftësi ndryshe, me aftësi të kufizuara, transferimet dhe studentët që përfitojnë zbritje të tarifave të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pranimi i studentëve në KU “Bedër” bëhet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve si dhe VKM në lidhje me mesataren e pranimit për programet Bachelor. Gjithashtu institucioni miraton kriteret të veçanta me vendim të Senatit [Evidenca nr. 22]. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar GVJ konstaton se këto kriteret hartohen dhe publikohen përpara çdo fillim viti akademik. Përveç kriterit hyrës të mesatares sipas VKM, që duhet të jetë minimalisht 6.5 për këtë program studimi, si kriteret të veçanta janë vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mesatarja e ponderuar e tre viteve të shkollës së mesme do të ketë masën e ndikimit 70%</li> <li>- Intervista me studentin në prani të komisionit të vlerësimit, do të ketë masën e ndikimit 30%.</li> </ul> <p>Komisioni i vlerësimit ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përgjegjës për programin e studimit [Evidenca nr. 58].</p> <p>GVJ konstaton gjithashtu që institucioni ka parashikuar edhe regjistrimin e studentëve të huaj, Neni 58 i Rregulloreve Themelore [Evidenca nr. 3]. Për vitin akademik 2023 – 2024, për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, janë parashikuar 3 kuota për studentë të huaj dhe 6 nga trojet [Evidenca nr. 66].</p> <p>Të gjitha kriteret janë të publikuara gjithashtu në faqen e web-it të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p>



	<p><u>Evidenca nr. 22. Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 58. Vendim për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e studentëve fitues për programin Bachelor Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</u>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151</a></p> <p><u>Evidenca nr. 66. Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit. Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</b></p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e cituar edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, si dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe janë të kuptueshme në Rregulloren Themelore të KU "Bedër". Gjithashtu këto informacione gjenden të aksesueshme për publikun edhe në faqen e web-it të institucionit.</p> <p>Përveç Rregullores Themelore, një burim shumë i vlefshëm informacioni është edhe Guida e Studentit e cila i jepet çdo studentit në fillim të studimeve. Çdo student që në fillim të vitit pajiset me llogarinë personale në sistemin e informacionit BIS, nëpërmjet të cilit mund të informohet për përparimin e tij gjatë kursit. Zyra e Sekretarisë Mësimore është në dispozicion të studentëve gjithashtu për të dhënë informacionet e nevojshme për të gjitha kriteret dhe procedurat e sipërpërmendura.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</u>  <u>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</u>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/transferimi-i-studimeve-6/6/157">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/transferimi-i-studimeve-6/6/157</a></p>
<p><b>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</b></p>	<p>GVJ konfirmon që institucioni publikon përpara fillimit të vitit akademik procedurat e pranimit të studentëve, së bashku me kuotat e miratuara nga ministria përkatëse për çdo program studimi, si dhe kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta për secilin prej tyre. Gjithashtu institucioni publikon edhe afatet e aplikimit dhe regjistrimit në raunde, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151</a></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p><a href="https://admission.beder.edu.al/apply">https://admission.beder.edu.al/apply</a></p> <p>Sikurse u evidentua edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë janë përcaktuar në Nenin 33, 34, 35, 36 edhe mundësitë për regjistrimin e studentëve me aftësi ndryshe, me aftësi të kufizuara, transferimet dhe studentët që përfitojnë zbritje të tarifave të studimit.</p> <p>Gjithashtu GVJ konfirmon që institucioni parashikon kuota për këtë kategori studentësh, më konkretisht evidentojmë për vitin akademik 2023 – 2024, për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, është caktuar 1 kuotë për studentët me statusin e jetimit, 1 kuotë për studentët me aftësi të kufizuar, 1 kuotë për studentët romë ose ballkano-egjiptianë [Evidenca nr. 66].</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 66. Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit. Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, GVJ konstaton që institucioni ka parashikuar edhe regjistrimin e studentëve të huaj, Neni 58 i Rregullores Themelore [Evidenca nr. 3]. Kriteret e pranimit dhe regjistrimit për studentët e huaj janë të publikuara edhe në faqen e web-it të institucionit, ku përveç kriterëve të njëjta me studentët vendas, janë përcaktuar edhe disa kritere të veçanta që lidhen me dokumentacionin që duhet të paraqesin kandidatët.</p> <p>Më konkretisht, për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, për vitin akademik 2023 – 2024 janë parashikuar 3 kuota për studentë të huaj dhe 6 nga trojet, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc, Medvegjë [Evidenca nr. 66].</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-10-11/6/151</a>  <u><a href="#">Evidenca nr. 66. Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit. Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për</p>	<p>GVJ konstaton, në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar [Evidenca nr. 59], që KU “Bedër” akordon një sërë bursash për studentët e shtresave në nevojë, apo për studentët që kanë fituar medalje apo kanë rezultate shumë të larta gjatë studimeve të</p>

<p>të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>shkollës së mesme. Kjo gjë u konfirmua edhe në takimin me studentët e këtij program studimi.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik përcaktohen kriteret për akordimin e bursave të cilat miratohen nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Më konkretisht GVJ konstaton se institucioni jep këto lloje bursash apo edhe zbritje të tarifave të studimit, për të mbështetur kategoritë e ndryshme të studentëve dhe për të rritur cilësinë e pranimeve në programet e veta të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bursat e ekselencës</li> <li>- Bursat sociale</li> <li>- Bursat e talentit</li> <li>- Bursat institucionale</li> <li>- Zbritjet e tarifave për rezervim të hershëm</li> </ul> <p>Të gjitha informacionet rreth bursave janë të publikuara edhe në faqen e web-it të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/bursat-e-studimit-2-1/6/154">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/bursat-e-studimit-2-1/6/154</a>  <i>Evidenca nr. 59. Miratimi i llojeve të zbritjeve të tarifave të studimit Signed.pdf</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KU "Bedër" harton dhe ndjek politika dhe procedura për pranimin e studentëve, transferimet, largimet, dhe mbulimin e gjithë ciklit të plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. GVJ konfirmon që këto politika dhe procedura garantojnë barazinë dhe të drejtat e studentëve.</i></p> <p><i>Përpara se të fillojë viti akademik, institucioni përcakton kuotat dhe harton kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit të studentëve dhe i bën ato publike. Në kuota janë parashikuar edhe studentë të huaj, studentë nga trojet, studentë të shtresave në nevojë apo të marginalizuara.</i></p> <p><i>Gjithashtu për rritjen e nivelit të studentëve si dhe të numrit të tyre, institucioni ka parashikuar akordimin e një sërë bursash studimi si dhe uljen e tarifave për shtresa të caktuara. Të gjitha informacionet janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.2**

<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik dhe kalimit të studentëve nga një vit në një tjetër përcaktohen në Rregulloren Themelore, Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve dhe në Guidën e Studentit. Gjithashtu studenti informohet nëpërmjet koordinatorit të departamentit, këshilltarit akademik apo sekretarisë mësimore. Një tjetër burim informacioni është sistemi i informacionit BIS, nëpërmjet të cilit studentët ndjekin përparimin e tyre akademik, notat, mungesat, etj.</p> <p><i>Gjatë takimit me studentët, GVJ konfirmoi që ata ishin të informuar për të gjitha procedurat dhe kriteret e vlerësimit, dhe kalimit nga një vit në tjetrin.</i></p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konstaton që KU “Bedër” lejon transferimet e studentëve nga IAL brenda ose jashtë vendit, publike ose private si dhe nga një program studimi në tjetrin midis departamenteve të vetë institucionit. Rregullorja për Transferimin e Studimeve [Evidenca nr. 41] përcakton qartë procedurat, dokumentacionin dhe afatet për njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme të studentëve.</p> <p>Për realizimin e procedurës së transferimit ngrihet një komision nga Këshilli i Departamentit, i cili bën njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të marra nga studenti, dhe vendos për transferimin. Komisioni njofton studentin për njohjen e lëndëve si dhe procedurat që do të ndjekë ai në vazhdim.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 41. Rregullorja për transferimin e studimeve Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve (Neni 13 – 27) si dhe në Guidën e Studentit. Studentët njihen me procedurën e vlerësimit edhe nëpërmjet syllabusit të çdo lënde i cili prezantohet në fillim të çdo semestri dhe është i aksesueshëm</p>

	<p>në çdo kohë nëpërmjet sistemit BIS ku studentët kanë llogaritë e tyre personale.</p> <p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, ata informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë edhe procedurën e vlerësimit të njohurive që ata do të marrin gjatë një lënde.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës dhe diplomimin në programet e studimit Bachelor janë përcaktuar në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve (Neni 15, 28) si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike (Neni 19).</p> <p>Për të mbështetur studentët institucioni ka përgatitur edhe “Manualin për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës”. Përveç informacionit që studenti mer nëpërmjet dokumentave të sipërcituara, në këtë program studimi punimi i diplomës është një lëndë e detyruar, që zhvillohet në semestrin e gjashtë, kështu që gjatë ndjekjes së saj studenti merr njohuritë e nevojshme për përgatitjen e diplomës nën dretimin e pedagogut përkatës.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 60. Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 29. Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni i kushton një rëndësi të veçantë informimit të maturantëve në lidhje me ofertën e tij akademike. Institucioni mban lidhje me Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe nëpërmjet Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median organizon takimet me maturantët për informimin e tyre rreth programeve të studimit që ky institucion ofron. Kjo zyrë është përgjegjëse për përgatitjen dhe publikimin e materialeve promovuese të institucionit, si fletëpalosje, broshura, katalogë, raporte aktivitetesh, albume etj.</p> <p>Gjithashtu rolin kryesor në informimin e maturantëve e luan Dekanati i Studentëve, nëpërmjet takimeve informuese nëpër gjimnaze, si dhe gjatë javës orientuese të fillimit të vitit akademik.</p>






	<i>Evidenca:</i> <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/marredheniet-me-publikun-dhe-median-19-4/4/272">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/marredheniet-me-publikun-dhe-median-19-4/4/272</a>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Procedurat e përparimit akademik dhe kalimit të studentëve nga një vit në një tjetër përcaktohen në Rregulloren Themelore, Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve dhe në Guidën e Studentit. Studentët janë të mirë informuar për të gjitha këto procedura.</i></p> <p><i>KU "Bedër" lejon transferimet e studentëve nga IAL brenda ose jashtë vendit, publike ose private si dhe nga një program studimi në tjetrin midis departamenteve të vetë institucionit. Rregullorja për Transferimin e Studimeve përcakton qartë procedurat, dokumentacionin dhe afatet për njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme të studentëve.</i></p> <p><i>GVJ konfirmoi që gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, studentët informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë edhe procedurën e vlerësimit të njohurive që ata do të marrin gjatë një lënde.</i></p> <p><i>Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës dhe diplomimin në programet e studimit Bachelor janë përcaktuar në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve si dhe në Manualin për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës. Studentët janë të njohur me këto procedura.</i></p> <p><i>Institucioni mban lidhje me Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe nëpërmjet Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median organizon takimet me maurantët për informimin e tyre rreth programeve të studimit që ky institucion ofron.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konfirmon se studentët që fillojnë studimet në programet e studimit të KU "Bedër" informohen gjatë javës së orientimit, e cila organizohet nga Dekanati i Studentëve. Program i orientimit [Evidenca nr. 68] organizohet sipas departamenteve, të cilat ofrojnë programet e studimit. Nëpërmjet takimeve të planifikuara studentët prezantohen me departamentin, klasat,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>bibliotekën, strukturën organizative të institucionit, etj. Që në fillim të studimeve, secilit grup i caktohet këshilltari akademik [Evidenca nr. 42, 74], i cili i udhëzon për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programimit të studimit. Ky informacion është i aksesueshëm dhe i qartë edhe në faqen e web-it të institucionit, si dhe në Guidën e Studentit [Evidenca nr. 28]. Këshilltari akademik e shoqëron studentin gjatë gjithë studimeve të tij, duke qenë udhëzuesi dhe ndihmësi kryesor për të gjitha proceset mësimore që lidhen me programin e studimit. Të gjitha këto më sipër u pohuan edhe nga studentët në takimin me ta.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 68. Programi i ditëve të Orientimit të studentëve 2023-20234 Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 42. Miratimi i Udhëzuesit të Këshilltarit Akademik Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 74. Caktimi i këshilltarëve akademikë për programet Bachelor, viti akademik 2023-2024 Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</i></u>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/kalendari-akademik-2023-2024-5/5/589">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/kalendari-akademik-2023-2024-5/5/589</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni në lidhje me lëndët/modulet, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese gjendet i qartë në syllabuset e lëndëve. Këto ju vihen në dispozicion studentëve që në javën e parë të fillimit të studimeve, nëpërmjet sistemit të informacionit BIS. Gjatë vizitës në institucion studentët pohuan gjithashtu se informacione të hollësishme studentët marrin edhe në fillimit të çdo semestri, nëpërmjet pedagogëve të lëndëve të cilët ju shpjegojnë programin lëndor, i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit dhe materialeve të lëndës, objektivave formuese, aftësive që fiton studenti, etj.</p> <p>Për çdo informacion në lidhje me këtë program studimi përsa i përket strukturës, organizimit, kohëzgjatjes së programit, etj, studentët kanë në dispozicion edhe Zyrën e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Specifikisht plani mësimor i programit të studimit gjendet edhe në faqen e web-it <a href="https://internal.beder.edu.al/sq/curriculum/33">https://internal.beder.edu.al/sq/curriculum/33</a> dhe është i aksesueshëm për të gjithë.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 40. Syllabuset e Lëndëve Signed.pdf</i></u>  <a href="https://internal.beder.edu.al/sq/curriculum/33">https://internal.beder.edu.al/sq/curriculum/33</a></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Planifikimit të Karrierës pranë Dekanatit të Studentëve, u informua se kjo zyrë orienton studentët drejt tregut të punës. Dekani i studentëve emëron nga një përfaqësues të çdo departamenti si këshilltar të karrierës [Evidenca nr. 61], i cili i orienton studentët për mundësitë e punësimit dhe qasjen drejt tregut të punës. Këshilltari i karrierës i udhëzon studentët për të përgatitur CV-në, letrat e motivimit, si të përgjigjen apo të sillen nëpër intervista pune, etj. Kjo zyrë organizon panairin e karierrës, nëpërmjet të cilit studentëve ju krijohen mundësi për tu njohur me tregun dhe për të dhënë intervista në kompani apo institucione me të cilat KU “Bedër” bashkëpunon. Zyra e të Diplomuarve [Evidenca nr. 96] organizon gjithashtu edhe aktivitete me alumni, edhe pasi ata kanë përfunduar studimet dhe janë shpërndarë në sektorë të ndryshëm të tregut.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 96. Raport i Zyrës së të Diplomuarve Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, GVJ konfirmon se studentët informohen hollësisht për infrastrukturën e institucionit, mjediset mësimore, strukturën e mësimit, orarin, për mjediset e tjera ndihmëse si: biblioteka, zyra e IT, sekretaria mësimore, zyra e klubeve të studentëve, e marrdhënieve ndërkombëtare, e planifikimit të karrierës, etj, nëpërmjet javës orientuese që në fillim të studimeve të tyre.</p> <p>Një informacion i bollshëm dhe i hollësishëm gjendet edhe në Guidën e Studentit, e cila i shoqëron ata gjatë gjithë studimeve. Në dispozicion të tyre është edhe Këshilltari Akademik i cili i informon studentët për çdo gjë që lidhet me organizimin e procesit mësimor dhe infrastrukturën mbështetëse.</p> <p>Organizimi i procesit mësimor dhe orari janë të publikura edhe në faqen e web-it (<a href="https://tt.beder.edu.al/">https://tt.beder.edu.al/</a>) si dhe ju vihen në dispozicion studentëve nëpërmjet sistemit BIS.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i</p>	<p>Sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër, KU “Bedër” përdor një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit, BIS (<a href="https://bis.beder.edu.al/">https://bis.beder.edu.al/</a>), i cili është i integruar, dhe bashkërendon punën e të gjitha njësive akademike dhe administrative të institucionit. Çdo student pajiset me kredencialet për llogarinë personale në këtë sistem që në javën e parë të studimeve. Nëpërmjet tij studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me procesin mësimor,</p>

arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>ecurinë e tyre, lëndët, oraret, notat, provimet, etj. Ata mund ta aksesojnë sistemin kudo ku ndodhen, edhe në mjedise të tjera jashtë institucionit, nëpërmjet aksesit në Internet.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Evidenca nr. 24. Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS) Signed.pdf</i></p>											
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Që në fillim të studimeve, secilit grup mësimor i caktohet këshilltari akademik i cili i udhëzon për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programimit të studimit. Ky informacion është i aksesueshëm dhe i qartë edhe në faqen e web-it të institucionit, si dhe në Guidën e Studentit.</i></p> <p><i>Informacioni në lidhje me lëndët/modulet, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese gjendet i qartë në syllabuset e lëndëve. Këto ju vihen në dispozicion studentëve që në javën e parë të fillimit të studimeve, nëpërmjet prezantimit të lëndëve nga pedagogët përkatës si dhe nëpërmjet sistemit të informacionit BIS.</i></p> <p><i>Dekani i studentëve emëron nga një përfaqësues të çdo departamenti si këshilltar të karrierës i cili i orienton studentët për mundësitë e punësimit dhe qasjen drejt tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon se studentët informohen hollësisht për infrastrukturën e institucionit, mjediset mësimore, strukturën e mësimit, orarin, për mjediset e tjera ndihmëse, nëpërmjet javës orientuese që në fillim të studimeve të tyre.</i></p> <p><i>KU "Bedër" përdor një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit, BIS i cili është i integruar, dhe bashkërendon punën e të gjitha njësive akademike dhe administrative të institucionit.</i></p>											
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X			
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
			X									

<p><b>Standardi V.4</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u njoh me regjistrat ku mbahen të dhënat e studentëve: të dhënat themeltare, të arritjeve akademike dhe të diplomave.</p> <p>GVJ konfirmon se institucioni mban statistika vjetore të numrit të studentëve të regjistruar apo të diplomuar, për të gjitha programet e studimit. Përsa i përket programit të studimit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, nuk ka akoma studentë të diplomuar, sepse ky program ka vetëm 3 vite akademike që është hapur.</p> <p>Gjithashtu GVJ gjeti evidenca edhe për transferimet apo largimet nga programet e studimit. Të gjitha këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe janë të qarta dhe të aksesueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Në bazë të këtyre statistikave GVJ konstaton që për këtë program studimi kemi [Tabela 21: Tabelat Përmbledhëse]:</p> <p>Tabela 1: Numri i të regjistruarve / transferuarve dhe mesatarja përkatëse</p> <table border="1" data-bbox="611 689 1337 922"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Studentë të regjistruar në vit të parë</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> <th>Studentë të transferuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>16</td> <td>8.67/10</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>28</td> <td>8.73/10</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>24</td> <td>8.48/10</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretarinë mësimore konfirmoi saktësinë e të dhënave të deklaruara.</p> <p><i>Evidenca:</i> <u><a href="#">RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</a></u></p>	Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar	2021-2022	16	8.67/10	-	2022-2023	28	8.73/10	-	2023-2024	24	8.48/10	1
Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar														
2021-2022	16	8.67/10	-														
2022-2023	28	8.73/10	-														
2023-2024	24	8.48/10	1														
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u njoh me dosjet fizike personale të studentëve, si dhe regjistrat fizikë, dhe bëri disa verifikime të rastësishme dhe nuk konstatoi pasaktësi apo mangësi. Përveç dokumentave fizike, të dhënat e studentëve janë të regjistruara dhe menaxhohen edhe nëpërmjet sistemit elektronik të informacionit BIS, nëpërmjet të cilit gjenerohen procesverbalet apo listat e notave të studentëve.</p> <p>GVJ u informua që këto të dhëna janë lehtësisht të aksesueshme nga personat e autorizuar, në përputhje me aktet normative të ruajtjes së të dhënave personale në KU “Bedër” [Evidenca nr. 89].</p> <p>Aksesi në sistemin BIS është i personalizuar për studentin, sipas numrit të tij të matricullimit, për pedagogun, këshilltarin akademik, apo edhe persona të tjerë të autorizuar.</p> <p><i>Evidenca:</i> <u><a href="#">Evidenca nr. 89. Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale Signed.pdf</a></u></p>																
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të</p>	<p>Sipas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni kryen kontrole periodike, për të vlerësuar dokumentacionin që lidhet me studentët, si dhe</p>																




<p>përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>saktësinë e të dhënave në të [Evidenca nr. 80]. Në bazë të këtyre kontrolleve institucioni ka hartuar raporte, ku jepen konstatimet që kanë dalë nga procesi i auditimit të brendshëm dhe rekomandimet e mundëshme në varësi të këtyre konstatimeve.</p> <p><i>Evidenca:</i> <u>Evidenca nr. 80. Raporti për auditimin periodik Signed.pdf</u></p>															
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p><i>GVJ konstaton se në fund të çdo viti akademik, çdo departament harton një raport analitik për ecurinë e programeve të studimit që ai ofron. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, përgjegjës për këtë program studimi, ka paraqitur Raportin Vjetor për vitin 2022 – 2023, në të cilin analizohen shumë aspekte që lidhen me ecurinë e departamentit, kërkimin shkencor, ecurinë e programeve të studimit, ecurinë dhe rezultatet mesatare të studentëve, etj [Evidenca nr. 67]. Në bazë të kësaj analize rezultojn:</i></p> <table border="1" data-bbox="635 1102 1310 1442"> <thead> <tr> <th>Viti akademik 2022-2023</th> <th>Studentë të regjistruar</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> <th>Studentë të shkëlqyer</th> <th>Studentë kalues</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Studentë në vit të I</td> <td>28</td> <td>8.73</td> <td>4</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Studentë në vit të II</td> <td>16</td> <td>8.67</td> <td>1</td> <td>14</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Në bazë të këtyre raporteve, departamentet hartojnë planin e masave që ndërmarrin në fillim të viti të ri akademik, me qëllim rritjen e performancës së programeve të studimit që ata ofrojnë.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <u>Evidenca nr. 67. Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023 Signed.pdf</u></p>	Viti akademik 2022-2023	Studentë të regjistruar	Nota mesatare në hyrje	Studentë të shkëlqyer	Studentë kalues	Studentë në vit të I	28	8.73	4	26	Studentë në vit të II	16	8.67	1	14
Viti akademik 2022-2023	Studentë të regjistruar	Nota mesatare në hyrje	Studentë të shkëlqyer	Studentë kalues												
Studentë në vit të I	28	8.73	4	26												
Studentë në vit të II	16	8.67	1	14												
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se institucioni mban statistika vjetore të numrit të studentëve të regjistruar apo të diplomuar, transferimet apo largimet, për të gjitha programet e studimit. Këto statistika mbahen nga Zyra e Sekretarisë Mësimore në regjistra fizikë,</i></p>															



	<i>dhe nëpërmjet sistemit elektronik BIS. Të dhënat mund të aksesohen lehtësisht nga personat e autorizuar. Institucioni bën kontrolle periodike mbi ruajtjen dhe saktësinë e të dhënave të studentëve. Departamentet hartojnë raporte vjetore analitike për ecurinë e programeve, ku përfshihen edhe analiza për cilësinë e studentëve gjatë studimeve të tyre.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve dhe angazhimi i tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të KU “Bedër” bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi (Ligji Nr. 80, 2015) dhe garantohet nëpërmjet Statutit të institucionit (Neni 10, 28). Studentëve ju jepet e drejta të kenë përfaqësues në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senatin Akademik</li> <li>- NJSBC</li> <li>- Këshillin e Departamentit</li> <li>- Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë</li> </ul> <p>Përfaqësuesit e studentëve në këto organe zgjidhen nga Këshilli Studentor (<a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/keshilli-studentor-7-2/7/161">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/keshilli-studentor-7-2/7/161</a>). Ky këshill është organi më i rëndësishëm studentor i universitetit, i përbërë nga përfaqësues të studentëve të zgjedhur përmes një procesi të përgjithshëm zgjedhor në mënyrë demokratike, modalitetet për zgjedhjen e anëtarëve si dhe për organizimin dhe funksionimin e tij përcaktohen në Nenin 99 të Statutit të institucionit dhe Neni 45 i Rregullores mbi Organizimin Administrativ.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 71. Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit Signed.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 97. Vendimi i zgjedhjes së Komisionit të përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilesisë Signed.pdf</i></p>



	<p><u>Evidenca nr. 11. Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 106. Rezultatet e zgjedhjeve studentore Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 107. Vendim për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi se KU “Bedër” është i angazhuar në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin në organet vendimmarrëse të institucionit, të përcaktuara në Nenin 113 të Rregullores Themelore.</p> <p>Gjatë takimit me studentët <i>GVJ konfirmoi se Këshilli Studentor funksionon dhe anëtarët e tij përçojnë shqetësimet apo sugjerimet e studentëve në të gjitha organet që ata marrin pjesë. Gjithashtu studentët pohuan se përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe programit të studimit është reale, dhe se vlerësimet apo kërkesat e tyre janë marrë në konsideratë.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><u>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar edhe tek konstatimet në dy kriteret e mësipërme të këtij standardi, GVJ konfirmon që përfshirja reale e studentëve në organet këshilluese dhe vendimmarrëse, mundëson që ata të jenë aktivë dhe të japin mendimin e tyre, në lidhje me cilësinë e programit të studimit si dhe të kontribuojnë në përmirësimin e tij. Nëpërmjet anketimeve që zhvillohen në fund të çdo semestri [Evidenca nr. 34, 47, 48], studentët japin në mënyrë të drejtpërdrejtë mendimin dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e kurrikulës mësimore. Rezultatet e anketave menaxhohen në mënyrë të pavarur nga NJSBC, dhe dërgohen në njësinë bazë, njësinë kryesore dhe Rektorat për tu analizuar dhe ndërmarrë planet e përmirësimit [Evidenca nr. 46].</p> <p>Përveç anketave që bëhen në fund të çdo semestri, KU “Bedër” realizon dhe anketimin e studentëve të diplomuar [Evidenca nr. 4] me qëllim përmirësimin e programit në përputhje edhe me kërkesat e tregut të punës të cilat reflektohen nga vetë studentët e diplomuar në këtë program.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><u>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</u></p>

	<p><u>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 4. Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Signed.pdf</u></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja Themelore (Neni 102), Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë të Studimeve (Neni 24), Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” (Neni 28) mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në procesin e kontrollit të dijeve, duke ju dhënë të drejtën studentëve për ankimim, rishikim apo përmirësim të rezultateve të provimit. Këto dokumenta përcaktojnë edhe procedurat që ndiqen nga institucioni në çdo rast.</p> <p><i>Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi se ata ishin të qartë për të gjitha procedurat, dhe pohuan se kjo e drejtë zbatohet nga ana e pedagogëve sa herë ata e kërkonin.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><u>Evidenca nr. 3. Rregullorja Themelore Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 6. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 35. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</u></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton përfshirjen e studentëve dhe angazhimi e tyre në: Senatin Akademik, NJSBC, Këshillin e Departamentit, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë.</p> <p>GVJ konfirmoi se Këshilli Studentor funksionon dhe anëtarët e tij përçojnë shqetësimet apo sugjerimet e studentëve në të gjitha organet që ata marrin pjesë.</p> <p>Studentët japin në mënyrë të drejtpërdrejtë mendimin dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e kurrikulës mësimore nëpërmjet anketimeve periodike në fund të çdo semestri apo edhe pas diplomimi.</p> <p>Institucioni mundëson barazinë dhe objektivitetin në procesin e kontrollit të dijeve, duke ju dhënë të drejtën studentëve për ankimim, rishikim apo përmirësim të rezultateve të provimit.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.6**

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>KU “Bedër” ka ngritur Dekanatin e Studentëve si njësinë përgjegjëse për mbarëvajtjen e marrdhënieve të studentëve me institucionin. Motoja e kësaj zyre është “Studenti në qendër të universitetit”. Misioni kryesor i saj është orientimi dhe informimi i studentëve, këshillimi dhe mbrojtja e të drejtave të tyre me anë të zyrave përkatëse. Mbështetja që kjo zyrë i jep studentit fillon që në aplikimin e tij për studime deri pas diplomimit. Dekanati i studentëve organizon dhe mbështet studentët në praktikat profesionale, në aktivitetet sociale, gjetjet e mundësive të punësimit etj.</p> <p>Në shërbim të informimit të studentëve është hartuar Guida e Studentit, faqja e web-it të institucionit, si dhe është asistimi i vazhdueshëm i Zyrës së Sekretarisë Mësimore apo Këshilltari Akademik.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ u informua se atyre nuk ju ka munguar informacioni apo ndihma e çdo njësie në institucion. Email-i zyrtar përdoret gjithashtu për çdo informacion që duhet të marrin studentët në kohë reale dhe që lidhet me procesin e tyre mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i> <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/dekanati-i-studenteve-3/424/425">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/dekanati-i-studenteve-3/424/425</a> <i>Evidenca nr. 28. Guida e Studentit Signed.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Dekanati i Studentëve i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrdhënieve të studentëve me institucionin, organizon ditët e orientimit për tu njohur studentët me strukturën mësimore.</li><li>- Koordinator i Programit i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë proceseve mësimore gjatë vitit akademik.</li><li>- Këshilltari Akademik i cili ndjek të gjitha proceset akademike dhe administrative që lidhen me studentët.</li><li>- Zyra e Marrdhënieve Ndërkombëtare që ndihmon studentët në aplikimet për mobilitetet, zgjedhjen e lëndëve në institucionet pritëse, etj.</li></ul>

	<p><b>Evidenca:</b>  <u>Evidenca nr. 68. Programi i ditëve të Orientimit të studentëve 2023-20234 Signed.pdf</u>  <u>Evidenca nr. 51. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit Signed.pdf</u>  <u>Evidenca nr. 74. Caktimi i këshilltarëve akademikë për programet Bachelor, viti akademik 2023-2024 Signed.pdf</u>  <u>Evidenca nr. 82. Caktimi i asistentit prane Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së të Diplomuarve, GVJ u informua që këto zyra ofrojnë shërbime të ndryshme këshillimi për studentët dhe të diplomuarit. Roli i Zyrës së Planifikimit të Karrierës konsiston në këshillimin e studentëve për zgjedhjen e institucionit për praktikën profesionale dhe ofrimin e mundësive të punësimit. Gjithashtu ajo ndihmon studentët në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për praktikën profesionale [Evidenca nr. 55]. Zyra bashkëpunon me departamentet të cilat emërojnë një Këshilltar Karriere [Evidenca nr. 61] pranë kësaj zyre. Këshilltari informon studentët për trajnime të ndryshme profesionale, seminare, workshop-e, brenda apo jashtë institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <u>Evidenca nr. 55. Procedura e praktikës profesionale Signed.pdf</u>  <u>Evidenca nr. 61. Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës Signed.pdf</u>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-planifikimit-te-karrieres-1-12/424/426">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-planifikimit-te-karrieres-1-12/424/426</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>KU “Bedër” ka ngritur nën varësinë e Dekanatit të Studentëve edhe Zyrën e të Diplomuarve e cila ka si qëllim të mbajë lidhjet midis institucionit dhe të diplomuarve dhe të ndihmojë në progresin e dyanshëm nëpërmjet organizimit të aktivitetetev si: Bedër Alumni Awards, Takim mes Brezash, Takim mes të diplomuarve, etj.</p> <p>Kjo zyrë mban të dhëna [Evidenca nr. 96] mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programet e studimit që ofrohen në KU “Bedër”, harton raporte të cilat i vë në dispozicion të organeve vendimmarrëse.</p> <p>Për këtë program studimi që po shqyrtohet në këtë raport nuk ka akoma të diplomuar sepse aktualisht është në vitin e 3-të akademik, dhe në fund të këtij viti priten të diplomuarit e parë.</p>




	<p>Evidenca për gjurmimin e të diplomuarve në rang institucional gjenden në Raportin Vjetor Institucional 2022 – 2023 [Evidenca nr. 13].</p> <p><b>Evidenca:</b>  <u>Evidenca nr. 96. Raport i Zyrës së të Diplomuarve Signed.pdf</u>  <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-te-diplomuarve-17-10/424/579">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-te-diplomuarve-17-10/424/579</a>  <u>Evidenca nr. 13. Raporti vjetor institucional, për vitin akademik 2022-2023 Signed.pdf</u></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>KU “Bedër” ka ngritur Dekanatin e Studentëve si njësinë përgjegjëse për mbarëvajtjen e marrdhënieve të studentëve me institucionin. Në shërbim të informimit të studentëve është Guida e Studentit, faqja e web-it të institucionit, si dhe asistimi i vazhdueshëm i Zyrës së Sekretarisë Mësimore apo Këshilltari Akademik.</i></p> <p><i>Institucioni ka ngritur struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve si Koordinatori i Programit, Këshilltari Akademik, Këshilltari i Karrierës, etj.</i></p> <p><i>Zyra e Planifikimit të Karrierës ndihmon studentët në këshillimin për zgjedhjen e institucionit për praktikën profesionale dhe ofrimin e mundësive të punësimit. Gjithashtu ajo ndihmon studentët në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për praktikën profesionale.</i></p> <p><i>Zyra e të Diplomuarve mban lidhjet midis institucionit dhe të diplomuarve dhe të ndihmon në progresin e dyanshëm të tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel</b>	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar Udhëzuesin mbi Mësimdhënien Inovative në KU “Bedër”. Në këtë dokument

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>shpjegohen mënyrat, qasjet dhe metodat e mësimdhënies që këshillohet të përdoren në programe të ndryshme studimi që ofrohen në këtë institucion. Në varësi të profilit dhe natyrës së programit pedagogët ndjekin udhëzimet, duke adoptuar qasje të ndryshme si qasja me në qendër studentin dhe qasja me në qendër lektorin.</p> <p>Ndër metodat inovative të sugjeruara për mësimdhënien mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qasja e të menduarit bazuar në dizajn.</li> <li>- Të nxënësit bazuar në projektet krijuese.</li> <li>- Të mësuarit bazuar në projekte.</li> <li>- Qasja klasa e përmbysur.</li> <li>- Vlerësimi i njëri-tjetrit.</li> </ul> <p>Në takimin me studentët GVJ u informua se disa nga format e mësimdhënies që përdoren ishin: leksionet, leksionet ndërvepruese, diskutimet, mësimdhënia e drejtpërdrejtë, mësimdhënia e udhëzuar, të mësuarit bazuar në raste studimi, të mësuarit bazuar në hulumtim, të mësuarit e bazuar në zgjidhjen e problemeve, të mësuarit e bazuar në projekte, dhe puna në terren.</p> <p><i>Evidenca:</i> <u><i>Evidenca nr. 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Bedër Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin periodik të personelit përsa i përket mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, detyra e të cilit lidhet kryesisht me garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Kolegjit Universitar “Bedër” (NJSBC), që është përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të menaxhimit dhe vlerësimit akademik dhe administrativ, përmirësimin e cilësisë, planifikimin strategjik, vlerësimin institucional, vlerësimin e jashtëm, kontrollin periodik, si edhe ndjekjen e përmirësimit të cilësisë në Kolegjit Universitar “Bedër”.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në përputhje me qëllimin e përcaktuar në Rregulloren e NJSBC [Evidenca nr. 17], strukturat përgjegjëse për monitorimin periodik përdorin mekanizma të ndryshme</p>



	<p>vlerësimi [Evidenca nr. 32, 34, 47, 48], nga të cilët përmendim aketimet e studentëve, për të vlerësuar format dhe metodat që përdorin pedagogët për mësimdhënien, vlerësimin e dijeve, trajtimin e ankesave të studentëve, etj.</p> <p><b>Në takimin me studentët GVJ konfirmoi pjesmarrjen e tyre në këto anketime.</b></p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies Signed.pdf</a></u>  <u><a href="#">Evidenca nr. 32. Rregullore e anketave dhe vlerësimeve Signed.pdf</a></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Nenit 18 të Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e NJSBC, publikimi i rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të KU “Bedër” është i detyrueshëm. Këto raporte publikohen në faqen e web-it të institucionit. Përsa i përket rezultateve të vlerësimit të pedagogëve dhe procesit të mësimdhënies, që NJSBC organizon në bashkëpunim me sekretarinë mësimore në fund të çdo semestri, raportimi bëhet në Senatin Akademik (Neni 11). Më pas këto rezultate përcillen nga Rektori tek përgjegjësit e departamenteve, e më pas tek pedagogu i lëndës. Gjithashtu ato janë të publikuara edhe në faqen e web-it <a href="https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports">https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports</a>.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><a href="#">Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</a></u>  <a href="https://qac.beder.edu.al">https://qac.beder.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, përgjegjës për këtë program studimi, GVJ u informua që departamenti analizon rezultatet e anketave që vijnë nga NJSBC, në lidhje me performancën e pedagogut dhe procesin e mësimdhënies, dhe reflekton rast pas rasti për marrjen e masave përkatëse. GVJ u informua që departamenti promovon pedagogët me performancë të lartë, dhe informon dhe inkurajon ata me performancë më të ulët për përmirësimin e vazhduar të metodës së mësimdhënies, duke i sugjeruar atyre pjesmarrjen në trajnime, apo leksione të hapura [Evidenca nr. 101].</p>

	<p><i>Megjithatë GVJ nuk gjeti ndonjë reflektim të rezultateve të gjetura nga pyetsorët në Raportin Vjetor të Departamentit. Sugjerojmë që të ketë një evidentim më të qartë të konkluzioneve të nxjera nga pyetsorët dhe masave të marra për adresimin e çështjeve që lidhen me to.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <i><u>Evidenca nr. 101. Lista e trajnimeve me qellim permiresimin e aftesive didaktike Signed.pdf</u></i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Disa nga forma e mësimdhënies që përdoren janë: leksionet, leksionet ndërvepruese, diskutimet, mësimdhënia e drejtpërdrejtë, mësimdhënia e udhëzuar, të mësuarit bazuar në raste studimi, të mësuarit bazuar në hulumtim, të mësuarit e bazuar në zgjidhjen e problemeve, të mësuarit e bazuar në projekte, dhe puna në terren. Institucioni inkurajon stafin edhe në përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies të tilla si: qasja e të menduarit bazuar në dizajn; të nxënëtarit bazuar në projektet krijuese; të mësuarit bazuar në projekte; qasja klasa e përmbysur; vlerësimi i njëri-tjetrit.</i></p> <p><i>NJSBC është struktura përgjegjëse për monitorimin periodik të formave dhe metodave që përdorin pedagogët për mësimdhënien, vlerësimin e dijeve, trajtimin e ankesave të studentëve, etj. Kjo njësi përdor mekanizma të ndryshme vlerësimi një nga të cilët është aketimi i studentëve. Në takimin me studentët GVJ konfirmoi pjesmarrjen e tyre në këto anketime. Rezultatet e këtyre anketave përcillen nga NJSBC tek Rektori, i cili ja dërgon ato përgjegjësit të departamenteve, e më pas përcillen tek pedagogu i lëndës.</i></p> <p><i>Departamenti analizon rezultatet e anketave që vijnë nga NJSBC, në lidhje me performancën e pedagogut dhe procesin e mësimdhënies, dhe reflekton rast pas rasti për marrjen e masave përkatëse.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura</b>	KU “Bedër” ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë e mësimdhënies në përputhje me kërkesat ligjore. Statuti në Kreun VIII parashikon ngritjen

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional (Neni 28, 29) dhe në Kreun XXIII politikat për sigurimin e cilësisë (Neni 89, 90, 91). Përbërja e anëtarëve të NJSBC është bërë në përputhje me kërkesat ligjore, në të ka 5 anëtarë nga të cilët edhe një student dhe një ekspert i jashtëm [Tabelat Përmbledhëse: Tabela 24].</p> <p>Struktura të tjera të përfshira në sigurimin e cilësisë janë edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni i përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë</li> <li>- Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin</li> <li>- Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës</li> </ul> <p>Gjithashtu institucioni ka hartuar Politikat e Cilësisë [Evidenca nr. 52] dhe Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit [Evidenca ne. 46], për të vënë në zbatim qëllimin dhe misionin e rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe programeve të studimit që ofron.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.pdf Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 19. Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 38. Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulave Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 52. Politika e cilësisë Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 46. Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në KU “Bedër” përbëhet nga Njësitë e përfshira në sigurimin dhe ruajtjen e cilësisë (të cituara në Kriterin 1), rregulloret përkatëse të këtyre njësive dhe instrumentat që përdoren për sigurimin e cilësisë. Ngritja e këtyre strukturave është bërë në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 kryetar, 2 anëtarë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore, 1 anëtar përfaqësues i Këshillit Studentor, 1 ekspert i jashtëm. Anëtarët miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.</p>

	<p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.pdf Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KU “Bedër” në funksion të sigurimit të jashtëm të cilësisë ka kaluar 3 procese akreditimi institucional. Gjithashtu institucioni aplikon periodikisht për akreditimin e programeve të studimit. Në lidhje me programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ky raport hartohet në kuadër të akreditimit për herë të parë.</p> <p>Përsa i përket proceseve të tjera që sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë e programeve të studimit, ato realizohen nëpërmjet këtyre instrumentave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Anketës së studentëve për vlerësimin e mësimdhënies</li> <li>- Anketës së studentëve për vlerësimin e lëndës</li> <li>- Anketës së studentëve për vlerësimin e institucionit</li> <li>- Anketës për vlerësimin e stafit akademik</li> <li>- Anketës së të diplomuarve për vlerësimin e programit të studimit</li> <li>- Etj,</li> </ul> <p>Të dhënat që merren nga pyetsorët përpunohen nga NJSBC dhe ju bëhen të ditura organeve drejtuese për marrjen e masave përkatëse.</p> <p>Raportet e vlerësimeve periodike të jashtëme dhe të brendëshme bëhen publike në faqen e web-it të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 65. Vendimi i Bordit të Akreditimit, nr.57, date 16.12.2021 Per akreditimin periodik të IAL Kolegji Universitar Beder Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve për institucionin Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve për institucionin Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 39. Formular vlerësimi për stafin akademik Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 49. Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Signed.pdf</i></u></p>

	<p><u>Evidenca nr. 4. Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit Signed.pdf</u></p> <p><u>Evidenca nr. 31. Anketa e stafit akademik dhe stafit administrativ Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4. Institucioni</b> përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe në kriteret e mësipërme, institucioni përdor disa instrumenta për të matur cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ndër to mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetsorët e studentëve për vlerësim e lëndëve dhe të pedagogëve.</li> <li>- Pyetsorët e vetvlerësimit të pedagogëve, për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</li> </ul> <p>Mbi bazën e këtyre pyetsorëve analizohet performance e programit të studimit në tërësi. Rezultatet e pyetsorëve ju bëhen të ditura Rektorit, Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe pedagogëve përkatës. Ato publikohen edhe në faqen e web-it <a href="https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports">https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports</a>. Në takimin me përgjegjësin e departamentit GVJ u informua që këto rezultate analizohen në mbledhje të departamentit për të promovuar shembujt më të suksesshëm dhe për të përmirësuar të tjerët. Megjithatë GVJ nuk gjeti ndonjë reflektim të rezultateve të gjetura në Raportin Vjetor të Departamentit. Sugjerojmë që në këtë raport të pasqyrohet në vija të përgjithshme, duke ruajtur anonimitetin, analiza e pyetsorëve dhe të përcaktohet plani i masave që ndërmerret në përputhje me gjetjet e tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> <u>Evidenca nr. 67. Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023 Signed.pdf</u></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KU "Bedër" ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë e mësimdhënies në përputhje me kërkesat ligjore.</i></p> <p><i>Struktura të përfshira në sigurimin e cilësisë janë: NJSBC, Komisioni i përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës.</i></p> <p><i>NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 kryetar, 2 anëtarë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore, 1 anëtar përfaqësues i Këshillit Studentor, 1 ekspert i jashtëm.</i></p> <p><i>Përsa i përket proceseve që sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë e programeve të studimit, ato realizohen nëpërmjet këtyre instrumentave: anketës së studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, anketës së studentëve për vlerësimin e lëndës, anketës së studentëve për vlerësimin e institucionit, anketës për</i></p>



	<p>vlerësimin e stafit akademik, anketës së të diplomuarve për vlerësimin e programit të studimit.</p> <p>Mbi bazën e këtyre pyetsorëve analizohet performance e programit të studimit në tërësi.</p> <p>Megjithatë GVJ nuk gjeti ndonjë reflektim të rezultateve të gjetura nga pyetsorët në Raportin Vjetor të Departamentit. Sugjerojmë që në këtë raport të pasqyrohet në vija të përgjithshme, duke ruajtur anonimitetin, analiza e pyetsorëve dhe të përcaktohet plani i masave që ndërmerret në përputhje me gjetjet e tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ka përdorur procese formale dhe të dokumentuara për mbikëqyrjen e këtij programi studimi, procese të cilat do ti shërbejnë akreditimit të tij. Gjatë 3 viteve të funksionimit të këtij programi, departamenti ka realizuar zhvillimin e anketimeve nga NJSBC, për të analizuar performancën e programit. Përsa i përket planit mësimor, ai nuk ka pasur ndryshime gjatë këtyre 3 viteve. Megjithatë në mbledhjet e departamentit janë diskutuar elementë që lidhen me programet lëndore, si përditësimi i literaturës, i metodave të mësimdhënies apo të vlerësimit, etj, të gjitha në funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe procesit të mësimi.</p> <p><i>Përsa i përket akreditimit institucional, institucioni ka hartuar një plan masash për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit [Evidenca nr. 115]. Në takimin me drejtuesit e institucionit, GVJ u informua që stafi është i angazhuar plotësisht në përmbushjen e rekomandimeve të lëna.</i></p> <p><i>Evidenca:</i>  <u>Evidenca nr. 115. Plani i masave për plotësimin e rekomandimeve të BA për institucionin Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të</p>	<p>Sikurse është evidentuar edhe në Kriterin 4 (Standardi VI.2), GVJ u informua që institucioni vlerëson rezultatet e pyetsorëve</p>



<p>përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>të cilët shërbejnë për të matur performancën e programit të studimit në tërësi, dhe rezultatet ju bëhen të ditura organeve drejtuese, Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Sipas RVB dhe takimit që GVJ zhvilloi me drejtuesit, ata pohuan se në institucion hartohen raporte të vlerësimit, të cilat evidentojnë praktikën më të mira dhe adresojnë problemet.</p> <p><i>Megjithatë GVJ nuk gjen një dokument specifik ku të evidentohen marrja e masave apo analizimi i rezultateve të marra nga pyetsorët. Sugjerojmë që njësitë bazë të përfshijnë analizat e rezultateve të pyetsorëve në raportet e tyre vjetore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Përsa i përket përmbushjes së këtij kriteri, në RVB referohen disa metoda vlerësimi që nuk kanë të bëjnë me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kurikulës, por kanë të bëjnë me vlerësimin e studentëve gjatë procesit mësimor.</p> <p>Në këtë kontekst GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk konstaton përdorimin e ndonjë metode të drejtpërdrejtë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Sugjerojmë që meqënëse stafi akademik i departamentit është kryeshisht i ri, të përfshihet në zhvillimin e orëve të hapura të mësimit, nën vëzhgimin e pedagogëve me tituj dhe grada shkencore, në mënyrë që të vlerësohet drejtpërdrejt ana didaktike dhe pedagogjike e tyre. Gjithashtu rekomandohet edhe vlerësimi paralel i provimeve nga dy pedagogë për të përmirësuar kompetencat dhe për të arritur në rezultate më të unifikura.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik,</p>	<p>Sikurse është evidentuar edhe në kriteret e mësipërme, institucioni përdor një sërë metodash dhe instrumentash të tërthorta në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve që ai ofron. Këto instrumenta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Anketën e studentëve për vlerësimin e mësimdhënies</li> <li>- Anketën e studentëve për vlerësimin e lëndës</li> <li>- Anketën e studentëve për vlerësimin e institucionit</li> <li>- Anketën për vlerësimin e stafit akademik</li> <li>- Anketën e të diplomuarve për vlerësimin e programit të studimit</li> <li>- Anketën e stafit akademik dhe administrativ</li> </ul>

<p>ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Të gjitha instrumentat e mësipërme janë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit dhe synojnë përmirësimin e kurrikulave në përputhje me nevojat e studentëve dhe tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve per institucionin Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve per institucionin Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 39. Formular vlerësimi për stafin akademik Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 49. Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 4. Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 31. Anketa e stafit akademik dhe stafit administrativ Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Në lidhje me akreditimin institucional, KU "Bedër" ka hartuar një plan masash për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit. Në takimin me drejtuesit e institucionit, GVJ u informua që stafi është i angazhuar plotësisht në përmbushjen e rekomandimeve të lëna.</p> <p>Përsa i përket vlerësimeve periodike të procesit mësimor nëpërmjet pyetsorëve, institucioni vlerëson rezultatet e pyetsorëve të cilët shërbejnë për të matur performancën e programit të studimit në tërësi, dhe rezultatet ju bëhen të ditura organeve drejtuese, Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Megjithatë GVJ nuk gjen një dokument specifik ku të evidentohen marrja e masave apo analizimi i rezultateve të marra nga pyetsorët. <u>Sugjerojmë që njësitë bazë të përfshijnë analizat e rezultateve të pyetsorëve në raportet e tyre vjetore.</u></p> <p>GVJ nuk konstaton përdorimin e ndonjë metode të drejtpërdrejtë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. <u>Sugjerojmë që meqënëse stafi akademik i departamentit është kryeshisht i ri, të përfshihet në zhvillimin e orëve të hapura të mësimit, nën vëzhgimin e pedagogëve me tituj dhe grada shkencore, në mënyrë që të vlerësohet drejtpërdrejt ana didaktike dhe pedagogjike e tyre.</u></p>

	<i>Institucioni përdor një sërë metodash dhe instrumentash të tërthorta në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve që ai ofron, të cilat janë efektive.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KU "Bedër" ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen: NJSBC, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 kryetar, 2 anëtarë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore, 1 anëtar përfaqësues i Këshillit Studentor, 1 ekspert i jashtëm, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme të institucionit.</p> <p>Në Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit përfshihen aktorët e brendshëm si: trupa menaxhuese, stafi akademik, studentët, stafi ndihmës dhe aktorë të jashtëm si: agjencitë qeveritare, sektori privat, media, alumni.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.pdf Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për funksionimin e njësive të ngritura të cilat sigurojnë garantimin e cilësisë të programeve të studimit.</p> <p>Në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së (Neni 11) janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e NJSBC.</p> <p>Në Rregulloren e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit (Neni 3) përcaktohen funksionet e Komisionit dhe (Neni 4) detyrat e kryetarit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>përgjegjësi të katër detyrave.</p>	<p><i>Gjatë takimit në institucion me përfaqësues të NJSBC, GVJ konstatoi se të gjithë anëtarët ushtrojnë detyrën e tyre me përgjegjësi, për të përmbushur objektivat e njësive.</i></p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 16. Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.pdf Signed.pdf</i></u></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon pjesmarrjen e njësive bazë dhe personelit në sigurimin e cilësisë së programit. Ky argument mbështetet tek pjesmarrja e tyre në anketimet që bëhen për vlerësimin e shërbimeve në institucion, bashkëpunimin, politikat e institucionit, ngarkesën mësimore, menaxhimin e përgjithshëm të institucionit, etj, [Evidenca nr. 31]. Gjithashtu analizat vjetore të departamenteve janë një mjet i tërthortë për përfshirjen e stafit dhe departamentit në sigurimin e brendshëm të cilësisë, sepse në to diskutohen rezultatet e përgjithshme të ecurisë së programeve dhe sugjerohen përmirësimet e mundëshme.</p> <p>Pjesmarrja e studentëve është e garantuar nëpërmjet mendimeve që ata japin gjatë plotësimit të anketimeve në fund të çdo semestri. Gjithashtu edhe pjesmarrja e të diplomuarve është e pëfshirë në plotësimin e anketave të dedikuara për ta.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u><i>Evidenca nr. 31. Anketa e stafit akademik dhe stafit administrativ Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve per institucionin Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 48. Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 47. Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 34. Anketa e studentit ndaj lëndës Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 50. Anketë vlerësimi i studenteve per institucionin Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 39. Formular vlerësimi për stafin akademik Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 49. Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Signed.pdf</i></u>  <u><i>Evidenca nr. 4. Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit Signed.pdf</i></u></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ realizoi në institucion me drejtuesin e departamentit si edhe me pedagogët e këtij programi studimi, u informua që gjatë procesit të anketimit dhe nxjerrjes së rezultateve të pyetsorëve nga NJSBC, nuk ka pasur cënim të integritetit si për stafin edhe për studentët.</p> <p><i>GVJ konfirmon që njësia operon në përputhje me Rregulloren e saj dhe në mënyrë etike dhe profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Evidenca nr. 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së Signed.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në kriteret më sipër, pjesë e NJSBC është edhe një anëtar ekspert i jashtëm, duke respektuar kërkesat ligjore për ndërtimin e këtij komisioni.</p> <p>Gjithashtu GVJ u informua që në proceset e sigurimit të cilësisë janë të përfshirë në mënyrë të tërthortë edhe aktorë të tjerë të jashtëm, profesionistë të fushës, që japin kontributin e tyre, me anë të takimeve, në kuadër të afrimit të programeve me kërkesat e tregut.</p> <p>Një kontribut në këtë proces japin edhe të diplomuarit në këtë institucion, të cilët nëpërmjet anketave për të diplomuarit, japin mendimet dhe sugjerimet e tyre për programet që kanë ndjekur dhe përshtatshëmrinë me vendin e punësimit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KU "Bedër" ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen NJSBC, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për funksionimin e njërive të ngritura të cilat sigurojnë garantimin e cilësisë të programeve të studimit, ku përshkruhen funksionet dhe detyrat e anëtarëve të komisioneve.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon pjesmarrjen e njësisë bazë dhe personelit në sigurimin e cilësisë së programit.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon që NJSBC operon në përputhje me Rregulloren e saj dhe në mënyrë etike dhe profesionale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.5**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al






**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni bën transparente të gjithë politikat, strategjitë, organizimin dhe aktivitetin e njëjësive që janë të përfshira në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit që ai ofron. Të gjitha këto informacione bëhen publike në faqen zyrtare <a href="https://qac.beder.edu.al/">https://qac.beder.edu.al/</a>, dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët apo këdo që është i interesuar.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://qac.beder.edu.al/">https://qac.beder.edu.al/</a>  <a href="https://qac.beder.edu.al/sq/page/calendar-of-igau">https://qac.beder.edu.al/sq/page/calendar-of-igau</a>  <a href="https://qac.beder.edu.al/sq/page/kodi-i-cilesise-ne-arsimin-e-larte">https://qac.beder.edu.al/sq/page/kodi-i-cilesise-ne-arsimin-e-larte</a>  <a href="https://qac.beder.edu.al/activities">https://qac.beder.edu.al/activities</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton që të gjitha raportet e hartuara nga NJSBC në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Raportet e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit, janë të publikuara në faqen zyrtare të web-it. Këto raporte janë hartuar duke ruajtur lirinë dhe etikën akademike dhe në përputhje me ruajtjen e privatësisë së të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <a href="https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports">https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports</a>  <a href="https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem">https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një plan masash për të adresuar rekomandimet e Bordit të Akreditimit në kuadër të akreditimit institucional. Ky plan është miratuar nga Senati Akademik [Evidenca nr. 115]. Në faqen e web-it <a href="https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions">https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions</a> janë publikuar të gjitha vendimet e Bordit të Akreditimit në lidhje me akreditimin institucional dhe të programeve të studimit që kanë kaluar në këtë process.</p> <p><i>Evidenca:</i>  <u>Evidenca nr. 115. Plani i masave për plotësimin e rekomandimeve të BA për institucionin Signed.pdf</u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin</p>	<p>Rezultatet e nxjerra nga përpunimi i anketave ju bëhen me dije organeve drejtuese të institucionit, Rektorit, Dekanëve dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Raportet që NJSBC harton</p>



e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	mbi bazën e këtyre rezultateve diskutohen në mbledhjet e departamenteve duke vlerësuar efektivitetin e këtyre instrumentave dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e programeve të studimit në tërësi.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se NJSBC si njësi përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë organizon veprimtari informuese me studentët dhe stafin për të prezantuar startegjinë e saj dhe instrumentat që përdor për procesin e monitorimit, si dhe për të ndërgjegjësuar ata për rëndësinë që ka procesi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në mbarëvajtjen e programeve të studimit.  <i>Evidenca:</i> <a href="https://qac.beder.edu.al/activities">https://qac.beder.edu.al/activities</a>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton që institucioni bën transparente të gjithë politikat, strategjitë, organizimin dhe aktivitetin e njërive që janë të përfshira në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit që ai ofron. Të gjitha këto informacione bëhen publike në faqen zyrtare <a href="https://qac.beder.edu.al/">https://qac.beder.edu.al/</a> . Raportet e NJSBC janë hartuar duke ruajtur lirinë dhe etikën akademike dhe në përputhje me ruajtjen e privatësisë së të dhënave personale. Institucioni ka hartuar një plan masash për të adresuar rekomandimet e Bordit të Akreditimit në kuadër të akreditimit institucional. Raportet që NJSBC harton diskutohen në mbledhjet e departamenteve duke vlerësuar efektivitetin e instrumentave dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e programeve të studimit në tërësi. NJSBC si njësi përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë organizon veprimtari informuese me studentët dhe stafin për të prezantuar startegjinë e saj dhe instrumentat që përdor për procesin e monitorimit.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar “Bedër”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Institucioni kujdeset në përditësimin e vazhduar të programit të studimit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE, dhe zhvillimet më të fundit të fushës.
2. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase dhe të huaja, përmes të cilave mundëson shkëmbimin e stafit dhe studentëve, ndarjen e eksperiencave dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit.
3. Institucioni në funksion të këtij programi studimi disponon laboratorë me pajisje bashkëkohore për zhvillimin e aftësive të studentëve në përputhje me nevojat konkrete të tregut e punës.
4. Institucioni punon në mënyrë të vazhduar në kuadër të sigurimit të cilësisë, duke bashkërenduar punën e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në këtë proces.
5. Realizimi i ngarkesës është në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
6. Përfshirja e studentëve në qeverisje dhe vendimmarrje është e konsiderueshme.
7. Institucioni organizon konferenca studentore që të angazhohen studentët me kërkim shkencor dhe prezantime.
8. Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.
9. Përfshirja e studentëve në mobilitetet ndërkombëtare është pozitive.
10. Literatura (hardcopy) dhe digjitale specifike, botime të viteve të fundit për fushën e Informatikës Ekonomike në gjuhën shqip dhe anglisht në bibliotekën e universitetit. Biblioteka ka një organizim dhe menaxhim shumë të mirë të fondit të librave si fizik edhe elektronik.
11. Lidhje e fortë dhe ndërvepruese student -pedagog.
12. Krijimi dhe angazhimi i studentëve në klubet studentore.

**Pika të dobta:**

1. Detyrat e kursit/projektet nuk janë evidentuar në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve si orë në auditor (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor). [(Standardi II.3/ Kriteri 4)]
2. Të ketë një përfshirje, shtimë të stafit akademik me titujt Profesor dhe Profesor i Asociuar në këtë program studimi. [(Standardi II.2/ Kriteri 1)]
3. Ka një mungesë të reflektimit të rezultateve të pyetsorëve të studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, në Raportin Vjetor të Departamentit dhe të planit të masave që ndërmerren për të promovuar rastet më të mira dhe për të adresuar problemet e ngritura. [(Standardi VI/ Kriteri 5)]

**Rekomandime:**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

1. Të evidentohen në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve numri i krediteve të dedikuara të detyrave të kursit/projekteve.
2. Të realizohet shpërndarja e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë referuar secilës kategori: leksion, seminar, laborator dhe detyre kursi.
3. Të krijohet mundësia e rekrutimit të stafit me tituj akademikë Profesor dhe Profesor i Asociuar.
4. Të reflektohet analiza e rezultateve të pyetsorëve të studentëve për vlerësimin e mësimdhënies në Raportin Vjetor të Departamentit, dhe të hartohet plani i masave që duhet të ndërmerren për të promovuar rastet më të mira dhe për të adresuar problemet e ngritura.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Economic Informatics" provided by the Higher Education Institution " Kolegji Universitar "Bedër" "**

**Strengths and affirmations**

1. The Institution takes care to continuously update the program of study, in accordance with the needs of the labor market, the similiar curricula of EU member countries and the latest developments in the field.
2. The Institution has cooperation agreements with national and international institutions, through which it enables the exchange of staff and students, the sharing of experiences and the development of professional practices of students in accordance with the needs of the program of study.
3. The institution has laboratories with modern equipment for the development of students' skills in accordance with the concrete needs of the labor market.
4. The institution works continuously in the framework of quality assurance, coordinating the work of all internal and external stakeholders in this process.
5. The teaching load of academic staf is in accordance with the legal and by-laws in force.
6. Involvement of students in governance and decision making is is at the right level.
7. The institution organizes Student Conferences which motivate to engage students in research works and presentations.
8. The institution motivates the students and partner instittutions in writting and enhancing the study programs, demonstrating a continuing enhancment in accademic offer.
9. Physical and digital literature is rich and updated in both Albanian and English language. The library has a very good organization and management of the books fund, both physical and electronic.
10. There is a positive involvement of students in international mobility.
11. Strong and interactive student-teacher relationship.
12. Creation and engagement of students in student clubs.

**Weaknesses**

1. Course assignments/projects are not identified in the curricula and syllabus as hours in the auditorium. [(Standard II.3, Criterion 4)]
2. There is a lack of involvement of Professors and Associate Professors in this study program. [(Standard II.2, Criterion 1)]

3. There is a lack of reflection of the results of the student questionnaires for teaching evaluation, in the Annual Report of the Department and of the plan of measures taken to promote the best cases and to address the issues raised. [(Standard VI, Criterion 5)]

#### Recommendation

1. Course assignments/projects needs to be identified in the curricula and syllabuses.
2. To determine the distribution of hours in the auditorium together with the relevant topics for each hour referring to each category: lecture, seminar, laboratory and course assignments.
3. To create the possibility of recruiting staff with the academic titles of Professor and Associate Professor for teaching in this study program.
4. To reflect the analysis of the results of the student questionnaires for the evaluation of teaching in the Annual Report of the Department, and to draw up the plan of measures to be taken to promote the best cases and to address the problems raised.

#### Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E				X

<b>PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)






